



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Elektronikë”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Elson Agastra
2. Dr. Lindita Dharmo

Maj 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për programin e studimit me karakter profesional në “Elektronikë” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Elektronikë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 699, datë 26.08.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 427, datë 17.12.2020, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim Nr. 83, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Me karakter profesional, pas arsimit të mesëm
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestër
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE/PAK = 12/6 Orë mësimore PAE/PAK 80/20%
18	Numri i studentëve:	11
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Profesional i Tiranës, është një institucion privat i arsimit të lartë, i licensuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr: 699, datë 26.08.2015 me statusin e Kolegjit Profesional.

Kolegji Profesional i Tiranës, përpara licensimit me VKM nr. 699, datë 26.08.2015, ka marrë vlerësimin paraprak për përputhshmërinë e programeve të studimit me kriteret dhe aktet rregullatore në fuqi, nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë. Vlerësim i pasqyruar në Vendimin Nr. 65, datë 30.06.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të lartë.

Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga dy njësi bazë, përkatësisht:

1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara

Programi i studimit me karakter profesional “Elektronikë” zhvillohet pranë njësisë bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit me kohëzgjatje normale akademike dy vite, 120 Kredite ECTS.

Akreditimi i parë i këtij programi studimi është realizuar në vitin 2017 me Vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për *“Akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në “Elektronikë”*”.

Në vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017, të BA, ASCAL, ky program studimi është akredituar me kohëzgjatje 5 (pesë) vite akademike deri më 30.09.2022 me rekomandimet:

1. Të përmirësohet raporti staf me kohë të plotë / staf me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi;
2. Të rritet numri i orëve praktike dhe të pasurohet më tej biblioteka me literaturë bashkëkohore në fushën e elektronikës.

Raporti i paraqitur në këtë dokument, si më poshtë vijon, është një vlerësim në kuadër të ri akreditimit periodik të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit me karakter profesional në “Aplikime Informatike”.

Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga “Kolegji Profesional i Tiranës”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

1. Prof. Asoc. Elson Agastra
2. Dr. Lindita Dhamo

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Msc. Rajna Lila.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Dhjetor 2022 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kolegji Profesional i Tiranës, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë” si dhe në Vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për “Akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, në “Elektronikë”, të Kolegjit Profesional të Tiranës”.

Gjatë vizitës së kryer në KPT, në datat 7 dhe 8 Shkurt 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Kolegjit Profesional të Tiranës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm rreth këtij program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017 janë:

1. Të përmirësohet raporti staf me kohë të plotë / staf me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi;
2. Të rritet numri i orëve praktike dhe të pasurohet më tej biblioteka me literaturë bashkëkohore në fushën e elektronikës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe vizitës në institucion konform agjendës, GVJ konfirmon se janë përmbushur plotësisht, 2 rekomandimet e lëna. Konkretisht:

1. Të përmirësohet raporti staf me kohë të plotë / staf me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi;

Kolegji Profesional i Tiranës ka përmirësuar raportin e stafit me kohë të plotë / staf me kohë të pjesshme të angazhuar në këtë program studimi duke realizuar një mbulim të ngarkesës mësimore në masën 80 / 20 %:

Viti akademik	Raport staf PAE / PAK	Orë ngarkese mësimore në përqindje PAE / PAK
2019 – 2020	12 / 6	80 / 20 %
2020 – 2021	11 / 4	78 / 22 %
2021 – 2022	4 / 3 (11 / 4) #)	60 / 40 % (78 / 22 %) #)
2022 – 2023	Nuk ka student të regjistruar	

#) *Shënim:* Në vitin akademik 2021 – 2022, nuk ka patur student të regjistruar në vitin e parë, dhe është zhvilluar vetëm viti i dytë me studentët e regjistruar në vitin e më parshëm akademik. Prandaj edhe raporti PAE/PÄK, i referohet vetëm për lëndët e vitit të dytë akademik dhe jo për gjithë programin e studimit. Lëndët e vitit të parë mbulohen nga staf PAE, çka e çon

Bazuar në të dhënat e përmbledhura në tabelë, ngarkesa mësimore, është realizuar mbi masën 70% nga staf akademik efektiv me kohët të plotë të Kolegjit Profesional të Tiranës.

GVJ gjykon se: Kolegji Profesional i Tiranës e ka përmbushur plotësisht rekomandimin e parë të Bordit të Akreditimit në vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017.

2. Të rritet numri i orëve praktike dhe të pasurohet më tej biblioteka me literaturë bashkëkohore në fushën e elektronikës.

Kolegji Profesional i Tiranës, përveç praktikës profesionale që realizohet në institucionet bashkëpunuese me një total prej 10 kredite ECTS (210 orë mësimore në auditor), ka shtuar në planin mësimor lëndën me emërtim “Praktikë” me 6 kredite ECTS. Gjithashtu, planet mësimore paraqesin një ngarkesë të orëve teorike / praktike në raport 50% me 50%.

Kolegji Profesional i Tiranës, ka pasuruar bibliotekën me materiale specifike në gjuhën shqipe, kryesisht materiale mësimore të hartuar nga stafi i këtij institucioni për realizimin e praktikave laboratorike dhe materiale mësimore në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe ka shtuar 57 titujsh librash të rinj si dhurim personal [Referencë Biblioteka].

Gjithashtu, është realizuar aksesimi në bibliotekë elektronike (online) në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës (<http://europs-services.ubt-uni.eu/login.php>). Kolegji Profesional i Tiranës ka realizuar edhe bibliotekën e hapur (<https://kolegjiprofesional.edu.al/online-library-oer>) duke mbledhur materiale mësimore në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit që ofron.

GVJ gjykon se: Kolegji Profesional i Tiranës e ka përmbushur plotësisht rekomandimin e dytë të Bordit të Akreditimit në vendimin Nr. 83, datë 21.09.2017.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programet e studimit të ofruan nga kjo IAL nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës, përpara licensimit me VKM nr. 699, datë 26.08.2015, ka marrë vlerësimin paraprak për përputhshmërinë e programeve të studimit me kriteret dhe aktet rregullatore në fuqi, nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë. Vlerësim i pasqyruar në Vendimin Nr. 65, datë 30.06.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të lartë.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimi profesional në “Elektronikë”, është një nga programet e para të hapura nga ky institucion, dhe është në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe fushën e tij të veprimtarisë.</p> <p>[Evidenca 1 VKM nr. 699]</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Referuar dokumentacionit të Dosjes së Vetëvlerësimit (për më tej DVV) rezulton se programi i studimit profesional “Elektronikë” është licencuar bazuar në VKM 699, datë 26.08.2015 dhe për herë të parë është aktivizuar në vitin akademik 2015-2016.</p> <p>Programi i studimit profesional “Elektronikë” është hartuar në linjë me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT). Referuar statutit dhe strategjisë së zhvillimit, misioni i KPT orientohet drejt krijimit, zhvillimit e transmetimit të dijeve, në pajisjen me aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për të qenë profesionistë në fushën e elektronikës dhe më në përgjithësi, në atë të teknologjisë së informacionit.</p> <p>[Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kërkimi i tregut], [Evidenca 7.1 Strategjia 2015-2020]</p>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal	<p>Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se KPT realizon në mënyrë periodike studime të tregut të punës në lidhje me fushën e këtij programi studimi. Edhe para hapjes së programit të studimit ka një studim të</p>

<p>e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>tregut lokal të punës. Gjithashtu, KPT përpunon të dhëna mbi kërkesën e tregut të punës, bazuar edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me aktorët kombëtar si punëdhënës potencial për studentët e këtij profili.</p> <p>[Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kërkimi i tregut], [Evidenca 7.1 Strategjia 2015-2020]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka përvojë mbi 7 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e elektronikës.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga dy njësi bazë, departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit 2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara <p>Ku për vitin akademik 2022 – 2023, janë angazhuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit: <ul style="list-style-type: none"> - 9 staf PAE, nga të cilët dy me titull akademik “Profesor”, një me kualifikimin “Master i Nivelit të Dytë” dhe gjashtë me kualifikimin “Master i Shkencave”. - 13 PAK, nga të cilët dy me gradën shkencore “Doktor”, 9 me kualifikimin “Master i Shkencave” dhe një me kualifikimin “Master Profesional” 2. Në Departamentin e Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara: <ul style="list-style-type: none"> - 10 staf PAE, nga të cilët dy me titull akademik “Profesor” dhe tetë me kualifikimin “Master i Shkencave”. <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, vërehet se në 5 vitet e fundit akademike (2017 – 2023), stafi akademik me kohë të plotë, i angazhuar pranë këtij institucioni, është i qëndrueshëm.</p> <p>[Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidenca 6 Të dhënat e studentëve në vite], [Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite]</p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga dy njësi bazë, departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit 2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara <p>Programi i studimit profesional në “Elektronikë” ofrohet në</p>

kombëtare e evropiane.	Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Program studimi që është në përputhje të plotë me fushën akademike të kësaj njësie bazë. [Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 3.1 Organigrama]			
Konkluzione	<i>Programi i studimit profesional "Elektronikë" ofrohet nga Kolegji Profesional i Tiranës, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i> <i>Programi i studimit bazohet në studime periodike dhe nevojave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Referuar Statutit të KPT, në dokumentacionin e DVV, ka një përcaktim dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave. Brenda njësive bazë që përbëjnë Kolegjin Profesional të Tiranës, ka një bashkëpunim ndërveprues i cili dëshmohet në mbulimin e lëndëve të programit të studimit nga pedagog të departamenteve të tjerë apo edhe përdorimin e bazës laboratorike dhe atyre njerëzore, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni. Gjatë takimit të zhvilluar me pedagogët e departamentit DIT, GVJ u informua nga pedagogët në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet tyre në funksion të përçimit të dijeve, si dhe studentëve në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p>Institucioni siguron edhe bashkëpunim dhe shpërndarje të kapaciteteve njerëzore, në funksion të përçimit maksimal të dijeve tek studentët, duke angazhuar edhe staf ndihmës akademik me përvojë në realizimin e aktiviteteve laboratorike/praktike.</p> <p>Angazhimi i stafit akademik dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore, realizohet në njësinë bazë dhe miratohet me vendim të Rektorit të KPT.</p> <p>[Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite], [Evidenca 6.2 Veprimtaritë e stafit në kuadër të projekteve trajnimeve], [Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT], [Evidenca 29.3 Vendimi i rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv], [Evidenca 29.4 Vendimi i rektoratit për miratimin e stafit me kohë të pjeshme]</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	Bazuar në DVV, institucioni ka realizuar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione si akademike (universitete) ashtu edhe

<p>vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>aktor të tregut të punës (kompani dhe institucione shtetërore). KPT dëshmon se ka realizuar një sërë marrëveshjesh afatgjate me qëllim bashkëpunimin në kuadër të praktikave mësimore dhe profesionale në përmbushje të programit të studimit. KPT ka realizuar edhe një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, jo vetëm për zhvillimin e praktikave mësimore, por edhe në realizimin dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.</p> <p>[Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidenca 40 Miratimi i mobilitetit të diplomës. Modeli i diplomës], [Evidenca 11 Lista e projekteve], [Evidenca 11.1 Workshop online USIA,MOVET], [Evidenca 11.2 MOVET desing thinking workshop], [Evidenca 11.3 USIA roundtable USIA], [Evidenca 11.4 Zyra USIA], [Evidenca 11.5 Thirrje për pjesëmarrjen në projekte], [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjate e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Departamenti i Teknologjisë së Informacioni, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit profesional në “Elektronikë”, në varësi të nevojave të programit të studimit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, gjithashtu janë lidhur marrëveshje me kompani të fushës së IT-së me qëllim të realizimit të praktikës profesionale dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Veprimtari e KPT e cila është e cituar edhe në Statutin e saj si dhe në strategjinë e zhvillimit institucional.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet]</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, vlerëson në mënyrë periodike bashkëpunimin me institucionet ku studentët e këtij programi studimi zhvillojnë praktikat profesionale.</p> <p>Në rregulloren e praktikave profesionale, është i caktuar edhe roli i pedagogut përgjegjës për ndjekjen dhe koordinimin e aktivitetit të studentëve në institucionet ku zhvillojnë praktikën, si dhe koordinimin/bashkëpunimin me personin/personat përgjegjës nga institucioni partner për mbarëvajtjen e të gjithë procesit. Gjithashtu, gjetjet, vështirësitë apo edhe cilësitë e bashkëpunimit me institucionet e tjera, diskutohen si në asamblenë e njësisë bazë, ashtu edhe në nivel rektorati.</p> <p>Një pjesë e këtyre gjetjeve bëhen pjesë edhe të raporteve të hartuara nga njësi sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>[Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve], [Evidenca 9 Mbledhje Rektorati Departamenti Asamble], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC], [Evidenca 36 Raporti vjetor]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL,</p>

<p>iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se nga institucioni janë siguruar trajnime profesionale për studentët e diplomuar në koordinim me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar qoftë nga akademia dhe industria.</p> <p>Një pjesë e studentëve të institucionit dhe në veçanti të këtij programi studimi, u është dhënë mundësia e realizimit të praktikave profesionale edhe në bashkëpunim me sipërmarrjen jashtë vendit, në kuadër të projekteve ndërkombëtare që institucioni ka aktive.</p> <p>Institucioni, në mënyrë të vazhduar, komunikon me studentët, mundësi punësimi, bazuar edhe në profilet e tyre të studimit. Megjithatë, kërkesa për punonjës të kualifikuar në fushën e këtij programi studimi është e lartë, çka vërtetohet edhe nga shkalla e lartë e punësimit të studentëve të këtij profili, ku rreth 50% e tyre janë të punësuar në institucionin ku zhvillojnë praktikën profesionale.</p> <p>[Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidenca 38 Praktika connectet through mobility], [Evidenca 44 Thirrje, njoftime punësimi], [Evidenca 12 Sondazhi alumni]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës, ka realizuar një sërë marrëveshjes në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi, duke i trajtuar edhe si punëdhënës potencial të studentëve të këtij profili.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një organ kolegjal si njësi e përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>Kjo njësi bazon punën e saj në statutin e institucionit dhe të gjithë akteve rregullatorë të brendshëm, në veçanti në rregulloren e saj. Megjithatë, GVJ, në shqyrtimin e dokumentacionit në DVV, dhe në veçanti, “Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Kolegjin Profesional të Tiranës (KPT)”, vuri re se kjo rregullore nuk ka një datë miratimi apo hyrje në fuqi. Në veçanti, përmbante në kreun VI të saj, një terminologji jo më në fuqi me ndryshimet institucionale që kanë ndodhur në arsimin e lartë në Shqipëri.</p> <p><i>Sugjerojmë institucionin, që çdo dokument, rregullore, udhëzim</i></p>

	<p><i>institucional, duhet të ketë të paktën datën e hyrjes në fuqi apo të miratimit.</i></p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 13 Vendimi i ngritjes së NJSBC], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal, e ngritur që në hapjen e institucionit dhe përbëhet nga gjashtë anëtar, nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njësive bazë (një për secilën njësi); një është përfaqësues i personelit administrativ; një është përfaqësues i Këshillit Studentor, një ekspert që drejton njësinë si dhe një ekspert i jashtëm i institucionit.</p> <p>Kjo njësi, bazon punën e saj në “Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Kolegjin Profesional të Tiranës (KPT)”. Në aktivitetin e saj, koordinon punën për përmirësimin e përvitshëm të programit të studimit, duke hartuar raporte për aktivitetet didaktike të zhvilluara në vitin e mbyllur akademik. Koordinon punën për rishikimin e programeve të studimit dhe plan-programeve të lëndëve në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Kjo njësi përfshihet edhe hartimi e pyetësorëve dhe shpërndarjen e tyre, si në vlerësimin e pedagogut, ashtu edhe në vlerësimin e aktiviteteve didaktike nga studentët.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 13 Vendimi i ngritjes së NJSBC], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet mekanizmave dhe strukturave të brendshëm të NJSBC. Në këtë kuadër, institucioni, mbledh dhe përpunon të dhëna si nga studentët, ashtu edhe nga ish studentët e diplomuar duke hartuar raporte në funksion të vendimmarrjes institucionale.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse (ASCAL). Akreditimi institucional është me vendim të Bordit të Akreditimit, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me vendim Nr. 66, datë 21.09.2017 me vlefshmëri deri më 30.09.2022.</p> <p>Institucioni ka kërkuar pranë ASCAL më datë 31.03.2022 (brenda vlefshmërisë së akreditimit institucional), akreditimin e programit të studimit profesional në “Elektronikë”.</p> <p>[Evidenca 1 VKM nr. 699], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 12 Sondazhi alumin], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mesimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet NJSBC, përdor kryesisht anketimet për mbledhjen e të dhënave. Megjithatë, në vlerësojmë pozitive faktin se anketimet nuk janë vetëm nga studentët, por edhe nga pedagogu/eprori për pedagogun dhe vetë-vlerësimi i pedagogut. Gërshetimi i këtyre</p>

<p>parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>formave të anketimeve dhe të dhënave, paraqet një vlerësim tërësor në formë më të plotë dhe plotësuese. Mekanizmi i cituar më sipër nuk është i veçantë për këtë program studimi, por përdoret në të gjithë institucionin si mënyrë e unifikuar metodologjike për mbledhjen e informacionit dhe më pas analizën e tij.</p> <p>Gjithashtu, institucioni realizon në mënyrë periodike vlerësimin e stafit akademik si dhe aftësive pedagogjike mësimdhënëse duke realizuar orë të hapura, apo edhe pjesëmarrje të stafit drejtues (drejtues departamenti apo rektor) në orë mësimdhënëse të stafit akademik. Në këto raste, evidentohen edhe nevojat për përmirësime apo kualifikime të mëtejshme të stafit.</p> <p>Gjithashtu, bazuar edhe në aftësitë profesionale të stafit të angazhuar pranë këtij institucioni, ofrohen edhe mundësi për pjesëmarrje apo shkrime projektesh si në nivel institucioni ashtu edhe për projekte ndërkombëtare si për promovimin e stafit, ashtu edhe të studentëve.</p> <p>[Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kërkimi i tregut], [Evidenca 7.1 Strategjia 2015-2020], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidenca 49 Prezantimet në departament], [Evidenca 11.5 Thirrje për pjesëmarrjen në projekte]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës, ka të ngritur dhe funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një organ kolegjal. KPT, në mënyrë periodike vlerëson cilësinë e mësimdhënies së stafit akademik dhe vë në dukje nevojat për përmirësime të mëtejshme</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	
--	------------------------------	-----------------------------	--	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<p>Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p style="text-align: center;">Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Elektronikë” është i</p>

<p>të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>organizuar në lëndë të vlerësuara me 120 kredite ECTS në total të shpërndara në 4 semestër (dy vite akademike).</p> <p>Referuar planit mësimor të programit të studimit profesional në “Elektronikë”, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe të të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, për programe studimit të nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.</p> <p>Gjithashtu, secila lëndë, ka të përcaktuar qartë ndarjen e krediteve në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime, Laborator/praktika si dhe orët përkatëse mësimore në auditor dhe jashtë tij për secilin aktivitet.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca 5.5 Syllabus], [Evidence shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se kurrikula e programit të studimit profesional në “Elektronikë”, është ndërtuar në përputhje me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve bazuar në Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar.</p> <p>Studentët në përfundim të studimeve të tyre fitojnë njohuri teorike dhe praktike profesionale mbi Sistemet elektronike, sistemet informatike dhe aftësive për të menaxhuar sisteme të teknologjisë së informacionit në tërësi. Studentët aftësohen të zgjidhin problematika të ndryshme në fushën e elektronikës dhe të ndërmarrin iniciativa për zhvillim të teknologjisë kompjuterike. Kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimit përfshijnë aftësimin teorik dhe atë praktik të studentit në fushën e zhvillimit të zgjidhjeve elektronike dhe aplikimeve të tyre. Për të zhvilluar mendimin kritik të studentëve, orët teorike plotësohen me ato praktike si në ushtrime ashtu edhe në ambiente laboratorike, ku studenti ka mundësinë të përforcojë njohuritë e mara në leksion.</p> <p>Studentët inkurajohen edhe në zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike inovative, ku një prej tyre ka qenë edhe realizimi i sistemit COPI (Customer Opinion System) i realizuar nga studentët e këtij programi studimi, zgjidhje që potencialisht mund të çojë në lindjen e një start-up në këtë fushë.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidence shtese COPI i KPTHUB Prezantimi dhe intervista LIBERALE Busines MAG], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT], [Evidenca 19.1 Kërkimi i aplikuar]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të publikuar në website të IAL, GVJ konstaton se janë të përcaktuara qartë objektivat e mësimdhënies, në planin strategjik të zhvillimit të këtij programi nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Ky program studimi realizohet në përputhje objektivat për formimin e studentëve me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat</p>

<p>programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>profesionale që duhet të fitohen në përfundim të këtij programi studimi dhe që kërkohen nga tregu i punës. Sipas “Planit strategjik të programit” disa nga objektivat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë gamës së pajisjeve elektronike duke filluar nga celularët, laptop, TV e deri tek pajisjet mjekësore e më tej; - Njohuri të thella tekniko-praktike në nivel profesional, që përbushin kërkesat në fusha të aplikimeve të elektronikës; - Administrimin e procesit të prodhimit, testimit, mirëmbajtjen dhe kalibrimin e aparaturave elektronike, sistemeve kompjuterike të telekomunikimit, të kontrollit e matjes; - Projektim dhe zbatim të sistemeve për aplikime komerciale, industriale, mjekësore, ushtarake ose shkencore në nivel profesional; - Vlerësimi i sistemeve dhe rekomandimi i modifikimeve të dizajnit dhe riparimit të pajisjeve; - Kontrolli dhe kalibrimi i pajisjeve dhe instrumenteve matëse dhe sistemeve elektronike për tu siguruar që ato përbushin standardet e sigurisë; - Planifikimi dhe zhvillimi i aplikacioneve për përmirësimin e performancës dhe efijencës së sistemeve elektronike. <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit te programit te studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar DVV, konstatojmë se plani mësimor, një ndër dokumentet kryesore të programit, shpreh qartë organizimin sipas viteve akademike të lëndëve të planifikuara. Çdo vit akademik është i ndarë në 2 semestra. Në plan mësimor ka informacion të plotë lidhur me lëndët për çdo semestër, ngarkesën mësimore në auditor sipas formave të mësimdhënies, ngarkesën në kredite për secilën veprimtari/disiplinë etj. Në përputhje me VKM nr.41/2018 të ndryshuar, plani mësimor ndjek logjikën e realizimit të lëndëve, shpërndan kreditet (orët) sipas lëndëve dhe brenda çdo lëndë sipas formës së aktiviteteve formuese (leksione, seminare/ushtime Laborator/praktike etj.).</p> <p>Referuar planit mësimor të programit të studimit profesional në “Elektronikë”, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe të të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, për programe studimit të nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren]</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>Forma e studimit të parashikuar për programin e studimit profesional në “Elektronikë”, është dy vite akademike me kohë të plotë.</p>

<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Pranimi i studentëve realizohet konform procedurave të parashikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila saktëson edhe kohët e aplikimit të studentëve, regjistrimin e tyre pranë institucioneve të arsimit të lartë publike dhe private.</p> <p>Procedurat e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, fillon që me përcaktimin e kuotave për çdo program studimi, vendim që fillon në njësinë bazë dhe miratohet në rektoratin e KPT. Kuota dhe të dhëna të tjera të nevojshme, përcillen pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin apo drejtorive përkatëse të cilat mundësojnë aplikimin e kandidatëve për student nëpërmjet portali U-Albania si për aplikimin, ashtu edhe regjistrimin e aplikantëve të interesuar.</p> <p>Vlerësimi i kapaciteteve financiare dhe burimeve të financimit, janë të saktësuara në Statutin e KPT si dhe në statutin e shoqërisë tregtare “KPT” shpk, e cila garanton mbarëvajtjen financiare.</p> <p>Institucioni funksionon me përcaktimin e projekt-buxhetit për çdo vit akademik si dhe me projekt-buxhet afatmesëm çdo pesë vite.</p> <p>Në të parashikohen jo vetëm tarifat e studimit, si një ndër mundësitë e financimit, por edhe objektivat e shpërndarjes së buxhetit në funksion të aktivitetit mësimor të këtij institucioni.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidence shtese Kapacitetet financiare]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nuk ka programe studimi me të njëjtën fushë të ofruar nga ky institucion.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Profesional në “Elektronikë”, i hapur që në vitin 2015, nuk ka qenë i kodifikuar, pasi mungonin aktet rregullatore të përcaktuara për këtë qëllim.</p> <p>Me hartimin e Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Profesional i Tiranës, ka realizuar kodifikimet e programeve të studimit që ofron, në përputhje me këtë udhëzim.</p> <p>[Evidenca 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit profesional në “Elektronikë”, ofrohet në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, për programe studimit të nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Ky program studimi është kodifikuar konform Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022 të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</i></p>
<p>Shkalla e përm. bushjes së</p>	<p>Përm. bushet Përm. bushet Përm. bushet</p>

standardit	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmesh kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret

Vlerësimi

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmesh detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Bazuar në Nenin 17, pika 7 e ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kolegji Profesional i Tiranës, në tre vitet e fundit akademike ka patur më pakë se 600 student për çdo vit (163 student janë regjistruar në vite të parë për vitin akademik 2020-2021), dhe si rrjedhojë, njësitë bazë të tij, nuk kanë detyrim për tu plotësuar me së paku tre anëtar me grada dhe tituj shkencor.

Më konkretisht, dy njësitë bazë që përbëjnë Kolegjin Profesional të Tiranës, kanë angazhuar si staf efektiv në vite përbërjen si më poshtë:

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit:

Kualifikimi	2017 – 2018	2018 – 2019	2019 – 2020	2020 – 2021	2021 – 2022	2022 – 2023
Prof. Dr.	3	3	3	2	2	2
Prof. Asoc.	0	0	0	0	0	0
DND	1	1	1	1	1	1
Msc.	11	9	7	7	6	6
Total	15	13	11	10	9	9

Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara:

Kualifikimi	2017 – 2018	2018 – 2019	2019 – 2020	2020 – 2021	2021 – 2022	2022 – 2023
Prof. Dr.	2	2	2	2	2	2
Prof. Asoc.	1	0	0	0	0	0
DND	0	0	0	0	0	0
Msc.	10	9	8	8	8	8
Total	13	11	10	10	10	10

Nga ana institucionale, Kolegji Profesional i Tiranës, është akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 66, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Tiranës” deri më datë 30.09.2022, dhe aktualisht është në pritje të akreditimit të radhës periodik institucional.

Programi i studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, është akredituar fillimisht me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 83, datë

	<p>21/09/2017, "Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm në "Elektronikë".</p> <p>Ky raport i vlerësimit të jashtëm, është në kuadër të akreditimit periodik të këtij programi studimi.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 3.1 Organigrama], [Evidenca shtese Lista e stafit akademik efektiv]</p>						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin e zhvilluar me anëtarët e departamenti DTI dhe drejtuesit e njësisë kryesore u konstatua se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi kanë përgjegjësinë kryesore dhe janë angazhuar për një mësimdhënie cilësore. Pjesa më e madhe e stafit ndihmës akademik ka përvojë të gjatë profesionale në fushën specifike të elektronikës apo fushave të tjera të lidhura me të.</p> <p>Stafi ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e praktikave mësimore në auditor, angazhohet jo vetëm në zhvillimin e aktiviteteve laboratorike, por edhe në hartimin e manualeve apo përshtatjen e tyre në gjuhën shqipe.</p> <p>Në mbarëvajtjen e aktiviteteve didaktike dhe administrative, institucioni ka të angazhuar edhe personel administrativ në funksion të sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore, asaj financiare etj.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 3.1 Organigrama], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 29.3 Vendimi i rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv], [Evidenca 29.4 Vendimi i rektoratit për miratimin e stafit me kohë të pjeshme]</p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Edhe në takimet informuese me stafin akademik dhe studentët e diplomuar në këtë program studimi, konfirmohet fakti se studentët kanë mundësi të marrin informacione të hollësishme për të gjithë veprimtaritë akademike dhe vlerësuese të zbatuara nga institucioni nga i gjithë stafi dhe në veçanti nga koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Në funksion të informimit të studentëve është edhe tutori i studentit për praktikën profesionale.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 41 E-maillet njoftuese nga koordinorët]</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës në tërësi dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1843 826 1937">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="826 1843 1050 1937">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1050 1843 1236 1937">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1937 826 2002"></td> <td data-bbox="826 1937 1050 2002"></td> <td data-bbox="1050 1937 1236 2002" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, disponon dhe ka vënë në dispozicion të stafit akademik të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidencë shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Referuar DVV, konstatojmë se plani mësimor, një ndër dokumentet kryesore të programit, shpreh qartë organizimin sipas viteve akademike të lëndëve të planifikuara. Çdo vit akademik është i ndarë në 2 semestra. Në plan mësimor ka informacion të plotë lidhur me lëndët për çdo semestër, ngarkesën mësimore në auditor sipas formave të mësimdhënies, ngarkesën në kredite për secilën veprimtari/disiplinë etj. Në përputhje me VKM nr.41/2018 të ndryshuar, plani mësimor ndjek logjikën e realizimit të lëndëve, shpërndan kreditet (orët) sipas lëndëve dhe brenda çdo lëndë sipas formës së aktiviteteve formuese (leksione, seminare/ushtrime Laborator/praktike etj.).</p> <p>Referuar planit mësimor të programit të studimit profesional në “Elektronikë”, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe të të specifikuara në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, për programe studimit të nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidencë shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 41.1 Kalandari akademik]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se plani mësimor është i detajuar, përfshirë ngarkesën mësimore në kredite ECTS të ndara për lëndë, dhe për secilën lëndë, është i ndarë në aktivitete formuese si leksione, ushtrime, laborator/praktikë etj. Në planin mësimor paraqitet edhe ndarja e detajuar e orëve në auditor për secilin aktivitet didaktik si dhe ato për studim individual.</p> <p>Syllabuset u prezantohen studentëve nga pedagogët e lëndëve në javën e parë të mësimit. Në të njëjtën kohë syllabuset u shpërndahen studentëve nëpërmjet koordinatorsit të programit të studimit apo</p>

	<p>pedagogeve titullar të lëndëve.</p> <p>Bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 60 % të orëve të leksioneve teorike si dhe 80% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës.</p> <p>Vlerësimi i njohurive të përvetësuar nga studentët bëhet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 60% Provimi i lëndës - 30% Kolokiume/detyra kursi i/laboratorë - 10% Aktivizimi në seminare/ushtrime <p>Informacione të detajuara dhe specifike për vlerësimin e secilës lëndë jepet në syllabuset përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka të saktësuar edhe rregullat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit profesional në “Elektronikë”. Kjo u konfirmua edhe nga biseda me sekretarinë mësimore ku GVJ konstatoi se ato pasqyronin saktë numrin e studentëve të pranuar, me te dhëna dhe dokumentacion të plotë referuar dosjeve të tyre.</p> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 18.1 Panairi i punës në KPT], [Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT], [Evidenca 24 Politika e komunikimit], [Evidenca 24.1 Turet], [Evidenca 24.2 Open days në KPT], [Evidenca 24.3 Screen shot tur 260 gradë], [Evidenca 24.4 Panairët work and Study. Panairi House of Europe], [Evidenca 30 Java e orientimit]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të programit me karakter profesional në “Elektronikë”, janë përgatitur sipas një formati standard dhe integrojnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimin e lëndës; - Kategorinë e lëndës; - Ngarkesën mësimore si në kredite ashtu edhe në orë mësimore për secilin aktivitet didaktik; - Semestrin dhe vitin kur zhvillohet lënda; - Përmbledhje e rezultateve të të nxënit; - Konceptet themelore që trajtohen; - Temat e trajtuara të ndara në javë mësimore; - Detyrimet e lëndës; - Laboratorët e parashikuar;

	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturën bazë; - Literaturën ndihmëse; - Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; <p>Syllabuset janë hartuar në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar.</p> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca shtese Silabuse elektronike]</p>						
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, GVJ evidentoi praktikën e punës në institucion, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.</p> <p>Kërkesa për ndryshimet në syllabusin e lëndëve, parashtrohet nga titullari i saj dhe pasi miratohet nga njësia bazë, miratohet edhe në rektoratin e institucionit.</p> <p>Të gjitha ndryshimet e propozuara dokumentohen në njësinë bazë, e cila ruan të gjitha syllabuset dhe planet mësimore për secilin vit akademik.</p> <p>[Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kërkimi i tregut], [Evidenca 9 Mbledhje Rektorati Departamenti Asamble], [Evidenca 12 Sondazhi alumni], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC], [Evidenca 36 Raporti vjetor]</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës mësimore, janë të detajuara me të gjithë parashikimet e VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Gjithashtu, paraqesin të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të dobishëm për studentët e këtij programi studimi për avancimin e tyre si akademik ashtu edhe profesional.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1682 820 1778">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="820 1682 1048 1778">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1048 1682 1230 1778">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1778 820 1845"></td> <td data-bbox="820 1778 1048 1845"></td> <td data-bbox="1048 1778 1230 1845" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret**Vlerësimi**

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit me karakter Profesional në “Elektronikë” është e organizuar në 2 vite akademike, me 120 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe publikohet në faqen ueb të KPT.

Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit profesional në “Elektronikë” rezultojnë i duhuri në përçimin e njohurive si teorike ashtu edhe praktike. Realizimi i një lënde të dedikuar praktike përtej asaj të zhvilluar në institucione të tjera po kompani, rezultojnë si një strategji e mirë në thellimin e karakterit profesional të të nxënit në këtë program studimi.

Praktikat në institucione të ndryshme, pjesëmarrjet në projektet në nivel institucioni, ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e tyre. Zhvillimi i praktikave profesionale parashikohet të realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucionesh e subjektsh të tjera private. Praktikant, kryesisht në vitin e fundit shikohen edhe si një mundësi për t’u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të hapur mundësinë e punësimit të tyre të ardhshëm.

[Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 22 Laboratorët]

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit profesional në “Elektronikë” si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Studentët e programit të studimit profesional në “Elektronikë” angazhohen në projekte apo grupe pune të organizuar nga institucioni edhe në kuadër të projekteve ndërkombëtare ku merr pjesë. Studentët e këtij programi studimi, bazuar edhe në projektet praktike të realizuara edhe me ndihmën e institucionit, janë vlerësuar pozitivisht duke nxjerrë në pah kompetencat e fituara në programin e studimit.

GVJ konstaton se në KPT, organizimi i aktivitetit didaktik është organizuar sipas akteve ligjore në fuqi në bazë viti akademik dhe semestra dhe lejon studentët që të ndjekin aktivitetin didaktik në bazë lëndësh, ku studentët pas sezonit të riprovimeve, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet në vitin pasardhës.

GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit profesional në “Elektronikë” është e shpërndarë në dy vite akademike dhe ndarja e orëve mësimore (në auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:

Viti / Semestri	Leksione	Ushtrime	Lab./Praktikë	Total Auditor	Studim individual	Total Viti
V. 1 / S. I	91	168	84	343	432	775
V. 1 / S. II	105	120	105	330	420	750
V. 2 / S. I	105	120	105	330	420	750
V. 2 / S. II	42	24	294	360	365	725
Total	343	432	588	1363	1637	3000

Ngarkesa e orëve mësimore në auditor dhe e orëve për studim individual të studentit përputhet me standardin e totalit prej 120 ECTS/3000 orë. Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite, kreditet, etj) rezulton i duhuri në përcimin e njohurive. Semestri i parë fillon me njohuri kryesisht të përgjithshme, si njohuri në matematikë, fizikë, baza e informatikës, etj. Që në semestrin e dytë të vitit të parë zhvillohen lëndë karakterizuese/profilizuese të lidhura me fushën specifike të studimit.

[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidence shtese Silabuse elektronike]

Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Programi i studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, ka një balancim të aktiviteteve didaktike teorike dhe praktike.

Studentët e këtij programi studimi, për të dy vitet zhvillojnë 120 kredite ECTS të ndara si më poshtë vijon:

- 49 kredite leksione
- 36 kredite ushtrime
- 28 kredite laborator/praktikë
- 7 kredite punim diplome/provim përfundimtar

Nga ku shohim se rreth 23% e krediteve janë të mirëfillta punë praktike në laborator apo pranë kompanive si praktikë profesionale.

Nëse analizojmë numrin e orëve mësimore për secilin aktivitet formues, nga plani mësimor vërejmë se:

- 343 orë leksione në auditor (teorike)
- 432 orë ushtrime në auditor (teorike dhe praktike)
- 378 orë laboratorike në institucion (praktike)
- 210 orë praktikë në institucione/kompani (praktike)

	<p>Nga ku shohim se aktivitetet teorike dhe praktike në institucion janë në raportin 1:1 duke konsideruar që ushtrimet gërshetojnë pjesën teorike me atë praktike në masë të barabartë.</p> <p>Këtij raporti, i shtohen edhe 210 orë praktike profesionale që studentët zhvillojnë pranë kompanive apo institucioneve partnere duke përforcuar kështu karakterin profesional të këtij programi studimi.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vërejmë se se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues për këtë program studimi me karakter profesional si dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit profesional në “Elektronikë”.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 21 Trajnime student]</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, GVJ evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.</p> <p>Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, dhe pasi miratohet në departament, propozimi shqyrtohet në Rektoratin e KPT për miratim.</p> <p>Me gjithë procedurën e brendshme të rishikimit të planeve mësimore dhe syllabuseve përkatëse, u vu re se një pjesë prej tyre nuk kanë literaturë të 5 viteve të fundit. Megjithatë, edhe në kuadër të karakterit profesional të këtij programi studimi, konceptet teorike të parashikuara në literaturën e përdorur, janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për formimin e kërkuar profesional.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Evidenca 34.3 Karta e bibliotekës], [Evidenca 34.4 Bibloteka online]</p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin</p>	<p>Programi i studimit me karkater profesional në “Elektronikë”, në thellimin e aftësive praktike të studentëve, zhvillon përveç aktiviteve laboratorike të parashikuara në secilën lëndë, edhe një lëndë të mirëfilltë “Praktikë” pranë KPT si dhe një aktivitet “Praktikë</p>

<p>praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Profesionale” pranë institucioneve/kompanive. Edhe nga takimi me studentë të këtij programi studimi, praktika e zhvilluar pranë kompanive shihet si një mundësi e mirë për të vendosur në zbatim njohuritë e marra gjatë këtij cikli studimesh. Aftësi të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga aktorët e tregut të punës duke e shprehur me shkallën e lartë të punësimit të studentëve në kompanitë ku kanë zhvilluar praktikën profesionale.</p> <p>[Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 21 Trajnime student]</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Programi i studimit me karakter Profesional në “Elektronikë”, ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon një program në nivelin 5 të Kornizës Shqiptar të Kualifikimeve (KSHK). Disa nga lëndët që ofrojnë aftësi teknike nga më të kërkuarat për profesionistët e fushës janë: Bazat e Elektronikës, Matje dhe Instrumente Elektronike, Qarqe të Elektronikës së Fuqisë, Mikroprocesorët dhe mikrokontrollerat, etj. si dhe lëndë më gjithëpërfshirëse në fushën e teknologjisë së informacionit si: Rrjetat e kompjuterave, Sistemet Operative, Protokollat e rrjetave dhe simulimi i tyre / E-commerce, etj.</p> <p>Organizimi i planit mësimor, lëndëve përkatëse mundëson aftësim praktik dhe gjithëpërfshirës në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve teknike në fushën e elektronikës.</p> <p>Këto aftësi janë evidentuar edhe nga shkalla e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi si dhe kërkesës së lartë të tregut të punës për specialist me këtë formim.</p> <p>[Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit], [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet], [Evidenca 12 Sondazhi alumni], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidenca 44 Thirrje, njoftime punësimi], [Evidenca 45 Regjistri bazë, Themeltar], [Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike], [Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura e këtij programi studimi, njohuritë teorike, kompetencat dhe aftësitë, janë në përputhje me karakterin profesional të këtij programi studimi, dhe në përputhje me ato të parashikuara në nivelin 5 të KSHK.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucioni afirmohet fakti që institucioni realizon anketime periodike me studentët për aktivitetet didaktike, por nuk realizon një korrelim të pyetjeve mes tyre për të identifikuar, nëse ka, problematika dhe origjinën e tyre.</p> <p>Opinionet dhe mendimet/propozimet e bashkëpunëtoreve apo partnerëve në projekte merren dhe analizohen kryesisht me takime. Nuk vihet re përdorimi i ndonjë procedure të mirë organizuar për të marrë dhe përpunuar të dhëna nga partnerë/bashkëpunëtor jashtë institucionit. Gjithashtu nuk ka një mekanizëm vlerësimi të efektivitetit të bashkëpunimeve të institucionit me palë të treta në kuadër të këtij programi studimi.</p> <p>Propozimet/sugjerimet e palëve të treta merren kryesisht nga takime individuale dhe subjektive. Megjithatë vihet re se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin dhe eksperiencën e duhur për të ndjekur nevojat e tregut dhe përmirësimin e programit të studimit në vijim.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti]. [Evidenca 4 Rregullorja KPT]. [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit]. [Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit]. [Evidenca 6.4 Anketa e stafit]. [Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kërkimi i tregut]. [Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL marrëveshjet]. [Evidenca 12 Sondazhi alumni]. [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik]. [Evidenca 31 Takimi me biznese]. [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, dhe në veçanti koordinatorët, mbajnë vazhdimisht kontakte me studentët si në funksion të zhvillimit të aktiviteteve didaktike në forma sa më gjithëpërfshirëse dhe të frytshme, ashtu edhe për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mësimor.</p> <p>Konsultimet me studentët e diplomuar, por në veçanti ato me aktorët e tregut të punës, janë pjesë e diskutimeve për përmirësimin e vazhduar të ofertës didaktike në tërësi të ofruar nga Kolegji Profesional i Tiranës.</p> <p>[Evidenca 12 Sondazhi alumni]. [Evidenca 41 E-mailet njoftuese nga koordinatorët]. [Evidenca 44 Thirrje, njoftime punësimi]. [Evidenca 49 Prezantimet në departament]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, ka përditësuar planet mësimore, dhe në veçanti pjesët laboratorike, në funksion të zhvillimeve të fundit teknologjike dhe laboratorëve që ka ngritur në funksion të këtij</p>

propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	<p>programi studimi në veçanti, por edhe të gjithë institucionit në tërësi.</p> <p>Kjo vërehet edhe në përshtatjen e udhëzuesve laboratorik në funksion të laboratorëve specifik të ngritur pranë këtij institucioni, si laborator “Smart Lab” duke parashikuar përçimin e njohurive në arkitekturat e sistemeve Smart Home, Smart building, Sisteme alarmi kundra zjarrit, CCTV, fibrave optike etj..</p> <p>[Evidence shtese Labororet Elektronike], [Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit]</p>			
Konkluzione	<i>KPT përfshinë në mënyrë të vazhduar studentët e këtij programi studimi në diskutime në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të aktiviteteve didaktike dhe përçimit të dijeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Vërejmë se në nivel institucional, KPT, ka miratuar rregullore dhe udhëzues dhe organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. Format e mësimdhënies janë të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione, seminare, laboratorë, provime, detyra kursi etj.</p> <p>Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 60 % të orëve të leksioneve teorike si dhe të paktën 80% të orëve laboratorike/praktike në terren që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, rezulton se 1637/3000 orë zhvillohen në auditor të ndara në aktivitetet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 343 orë janë leksione në auditor;

	<ul style="list-style-type: none"> - 432 orë janë seminare/ushtrime në auditor; - 378 orë janë orë laborator/praktikë në auditor; - 210 orë praktikë profesional në kompani; - 12 orë provim/punim diplome në auditor; <p>Leksionet e hapura, debatet me ekspertë të ftuar të njohur, diskutimet me aktorët e tregut të punës si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca 11.1 Workshop online USIA, MOVET], [Evidenca 11.2 MOVET desing thinking workshop], [Evidenca 11.3 USIA roundtable USIA], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 17.1 Rregullore tutoriati], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT], [Evidenca 19.1 Kërkimi i aplikuar], [Evidenca 20 KPT HUB], [Evidenca 21 Trajnime studentë], [Evidenca 22 Laboratorët], [Evidenca 26 Trajnimi polytech EU masterclass], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve janë të parashikuara forma e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke ju përshtatur fushës dhe natyrës së lëndëve specifike të programit të studimit, leksion, seminare, laboratorë, projekte, praktika profesionale, si dhe aktivitete dhe pjesëmarrjes në projekte të shkëmbimit studentor Erasmus etj.. Të gjitha materialet mësimore gjenden në formën klasike si: libra fizik në bibliotekë, literaturë elektronike si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet platformës elektronike në përdorim nga KPT. Gjithashtu, institucioni ka përdorur me sukses edhe platformat online të përqimit të dijeve, sidomos gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e pandemisë Sars-Cov2. Personeli akademik është i mirë përgatitur dhe përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit të lëndëve duke alternuar pjesën teorike me ato praktike në laboratorët e institucionit.</p> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 6.2 Veprimtaritë e stafit në kuadër të projekteve trajnimeve], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 17.1 Rregullore tutoriati], [Evidenca 25 Mësimi online. Zyra IT video tutorial. Manual Komunikimi], [Evidenca 26 Trajnimi polytech EU masterclass], [Evidenca 34.1 Infrastruktura IT], [Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Evidenca 34.3 Karta e bibliotekës], [Evidenca 34.4 Bibloteka online]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstaton se</p>

<p>personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Institucioni rekruton staf akademik të kualifikuar dhe kompetent në fushën e tij të ekspertizës profesionale. Gjithashtu, janë organizuar programe trajnimi të strukturuar (seminare dhe workshope lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor, projektet etj.) në nivel institucioni, stafi akademik përfshihet në programet e shkëmbimit të stafit me Universitetet e tjera partnere me të cilat ka marrëveshje (Erasmus +).</p> <p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura, workshope si dhe trajnime specifike në kuadër të moduleve specifike laboratorike.</p> <p>[Evidenca 6.2 Veprimtaritë e stafit në kuadër të projekteve trajnimeve], [Evidenca 9 Mbledhje Rektorati Departamenti Asamble], [Evidenca 26 Trajnimi polytech EU masterclass], [Evidenca 28 Manuali classter], [Evidenca 28.1 Sistemi classter], [Evidenca 49 Prezantimet në departament]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik transmeton njohuritë dhe konceptet e lëndës të studentit duke konkretizuar ato dhe me raste konkrete të eksperiencave profesionale të tyre. Kjo pasi Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie dhe, se shpërndarja e lëndëve të programit tek stafi akademik realizohet duke u bazuar në fushat e eksperiencës së tyre. Ndihejmon këtu edhe angazhimi në projekte të ndryshme, trajnimi i vazhdueshëm etj.</p> <p>[Evidenca 6.2 Veprimtaritë e stafit në kuadër të projekteve trajnimeve], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë], [Evidenca 29.3 Vendimi i rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv], [Evidenca 29.4 Vendimi i rektoratit për miratimin e stafit me kohë të pjesshme], [Evidenca 47 Kodi i etikës dhe integritetit], [Evidenca shtese Cv stafi akademik efektiv], [Evidenca shtese Cv stafi akademik me kohe te pjesshme]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. Gjatë vizitës në IAL, nga takimi dhe komunikimi me studentët pjesëmarrës të programit të studimit me karakter Profesional në “Elektronikë”, rezultoi se ishin të kënaqur nga infrastruktura dhe metodat e përdorura në mësimdhënie nga personeli akademik dhe në sistemin online.</p>

	[Evidenca 6.4 Anketa e stafit], [Evidenca 12 Sondazhi alumni], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC]			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura në nivel institucional si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) që është njësi kryesore, një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>Një ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Gjithashtu, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë kujdeset që kuadri rregullator i IAL të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i këtyre strukturave është përcaktuar në statutin e IAL dhe dokumentin e funksionimit të NJSBC dhe manualit të sigurimit të cilësisë të institucionit. KOT ka hartuar strategjinë dhe planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku jepen politikat e objektivave kryesore dhe standardet e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në IAL. Përveç këtyre strukturat drejtuese janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 11.5 Thirrje për pjesëmarrjen në projekte], [Evidenca 13 Vendimi i ngritjes së NJSBC], [Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë], [Evidenca 17.1 Rregullore tutoriati], [Evidenca 27 Manuali i studentit]</p>			
Konkluzione	<i>KPT, në angazhimin e mësimdhënies, ka fuqizuar bazën laboratorike me module dhe makete gjithëpërfshirëse jo vetëm në fushën e elektronikës, por në tërësi të të gjitha profileve të programeve që ofron. Kjo mundëson një proces transferimi të njohurive efikase tek studentët dhe rrit rezultatet e tyre në procesin e të nxëniet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme,	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit si dhe në syllabusin e secilës lëndë. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e

<p>bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet specifikisht për çdo lëndë në syllabus, në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i aksesojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi - 30 % Kolokiume/detyra kursi/laboratorë - 60 % provimi përfundimtar. <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloren e KPT-se, rregulloren specifike të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton që procesi i informimit të jetë një praktikë e ndjekur jo vetëm nga stafi akademik në ditët e para të leksioneve që zhvillon me studentët, por edhe në udhëzimet e hartuara në formë manuali të përmbledhur për studentët. Në mënyrë specifike, studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Referuar rregulloreve institucionale, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për mbrojtjen e diplomës/provimin përfundimtar.</p> <p>Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës dhe argumenteve të saj bëhet sipas gjykimit të pedagogut përgjegjës të lëndës dhe më pas miratohet nga drejtuesi i njësishë bazë.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>

Konkluzione	<i>KPT ka të detajuara në rregulloren e programit të studimit dhe në secilin syllabus, mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët. Informacioni i cili u bëhet i ditur studentëve paraprakisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formave të vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës dhe në tërësi rezultojnë si një vlerësim i:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi – 30 % Kolokiume/detyra kursi/laboratorë – 60 % provimi përfundimtar. <p>Informacion që gjendet edhe në syllabusin e lëndës, dhe që studentë informohen nga pedagogu përgjegjës. Gjithashtu, ky informacion gjendet edhe në manualin e studentit dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidenca shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, KPT përdor sekretimin e provimeve. Pedagogu i lëndës ka në dispozicion provimet e studentëve në formë anonime dhe vetëm në sekretarinë mësimore, kur ato dorëzohen të korrigjuara, pedagogu nuk ka informacione rreth studentit.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka përdorur me efikasitet edhe sistemet e testimit online të ofruara nga paketa Microsoft Office 365 dhe moduli Microsoft Teams, duke realizuar edhe testime në format kuicesh (me alternativa) ose e kombinuar dhe me pyetje të natyrës teorike, të cilat korrigjohen nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës dhe diskutohen/mbrohen.</p> <p>Stafi akademik ka patur mbështetjen e stafit IT për mbarëvajtjen dhe</p>

	<p>organizimin e sistemeve elektronike të përdorura në funksion të përçimit dhe testimit të dijeve.</p> <p>[Evidenca 25 Mësimi online. Zyra IT video tutorial. Manual Komunikimi]</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga njësia bazë dhe të miratuara nga Rektori i institucionit sikurse parashikohet nga rregullorja institucionale. Komisioni i provimit, gjithashtu, vlerëson në tërësi studentit bazuar edhe në vlerësimet e vazhduara gjatë zhvillimit të lëndës sikurse është parashikuar në syllabusin e lëndës, ku forma përfundimtare e vlerësimit është një peshim i vlerësimeve si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi - 30 % Kolokiume/detyra kursi/laboratorë - 60 % provimi përfundimtar. <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të KPT-së. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia bazë dhe personeli akademik bazohen në rregulloret institucionale dhe kodin e etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave (për studentët që zgjedhin punim diplome kundrejt provimit përfundimtar), personeli akademik dhe drejtuesi i njësisë bazë, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimeve të diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe kodit të etikës në KPT.</p>

	<p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 47 Kodi i etikës dhe integritetit]</p>																																										
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem pikëzimi nga 0 (zero) në 100 (një qind). Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi elektronik i sekretarisë mësimore, ose/dhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigohet nga komisioni dhe brenda tre ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit elektronik. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p> <p>Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuice, prezantime ne grup ose individuale, etj.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me pikë të cilat konvertohen në notë sipas vlerësimit të përdorur në Shqipëri me nota nga 4 (jo kalues) në 10 (maksimale). Institucioni, në rregulloren e programi të studimit, ka përcaktuar edhe tabelën e ekuivalentimit nga pikë në notë dhe në vlerësim ne shkronja si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="603 1048 1414 1608"> <thead> <tr> <th>Pikët</th> <th>Nota</th> <th>Gërma</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>96 – 100</td> <td>10</td> <td>A</td> </tr> <tr> <td>91 – 95</td> <td>10</td> <td>A-</td> </tr> <tr> <td>86 – 90</td> <td>9</td> <td>B+</td> </tr> <tr> <td>81 – 85</td> <td>9</td> <td>B</td> </tr> <tr> <td>76 – 80</td> <td>8</td> <td>B-</td> </tr> <tr> <td>71 – 75</td> <td>8</td> <td>C+</td> </tr> <tr> <td>66 – 70</td> <td>7</td> <td>C</td> </tr> <tr> <td>61 – 65</td> <td>7</td> <td>C-</td> </tr> <tr> <td>56 – 60</td> <td>6</td> <td>D+</td> </tr> <tr> <td>51 – 55</td> <td>6</td> <td>D</td> </tr> <tr> <td>46 – 50</td> <td>5</td> <td>D-</td> </tr> <tr> <td>41 – 45</td> <td>5</td> <td>E</td> </tr> <tr> <td>0 – 40</td> <td>4</td> <td>F</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 28 Manuali classter], [Evidenca 28.1 Sistemi classter], [Evidenca 34.1 Inrastruktura IT]</p>	Pikët	Nota	Gërma	96 – 100	10	A	91 – 95	10	A-	86 – 90	9	B+	81 – 85	9	B	76 – 80	8	B-	71 – 75	8	C+	66 – 70	7	C	61 – 65	7	C-	56 – 60	6	D+	51 – 55	6	D	46 – 50	5	D-	41 – 45	5	E	0 – 40	4	F
Pikët	Nota	Gërma																																									
96 – 100	10	A																																									
91 – 95	10	A-																																									
86 – 90	9	B+																																									
81 – 85	9	B																																									
76 – 80	8	B-																																									
71 – 75	8	C+																																									
66 – 70	7	C																																									
61 – 65	7	C-																																									
56 – 60	6	D+																																									
51 – 55	6	D																																									
46 – 50	5	D-																																									
41 – 45	5	E																																									
0 – 40	4	F																																									
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.</p> <p>Pas kësaj faze, nëse studenti gjykon se ka të drejtë, sërisht mund të</p>																																										

	<p>kontestojë vlerësimin në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë deri në Rektorat.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 47 Kodi i etikës dhe integritetit]</p>								
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Kërkesa për ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloret institucionale dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në KPT.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 47 Kodi i etikës dhe integritetit]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KPT vlerëson studentet në formë transparente dhe asnjëse duke garantuar të drejtën e tyre për tu informuar rreth vlerësimit dhe procedurat për kontestimin e vlerësimit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përrabushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përrabushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përrabushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit Profesional në “Elektronikë”, përfshin lëndë teorike dhe praktike në fushën e elektronikës, në fushën e teknologjisë së informacionit, praktiken profesionale dhe provimin përfundimtar/diplomën. Kjo kurrikul parapërgatit studentët për tregun e punë si profesionist të diagnostikimit, mirëmbajtës dhe instalimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe në veçanti atyre elektronike.</p> <p>Syllabuset e lëndës paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në secilën lëndën si dhe format e vlerësimit të njohurive.</p> <p>Njësia bazë, ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafii akademik përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studentëve ndihmojnë në përthithjen e aftësive praktike në fushën e elektronikës.</p> <p>Studentët inkurajohen për të punuar në grup gjatë aktiviteteve laboratorike duke praktikuar sipas moduleve të mirëfillta didaktike/laboratorike për përcimin e njohurive në këtë fushë.</p>

	<p>KPT ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat profesionale dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, e ka në fokus zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca 6.5 NASA hackathon konkurse], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 20 KPT HUB], [Evidenca 21 Trajnime studentë], [Evidenca 22 Laboratorët], [Evidenca 26 Trajnimi polytech EU masterclass], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidence shtese kapacitetet infrastrukurore], [Evidence shtese Laboratorët Elektronike]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit që zhvillohet në dy vite akademike në gjuhën shqipe, garanton përveç zhvillimit të aftësive në fushën e elektronikës, që është pjesë e kompetencës së këtij programi studimi, mbështet edhe zhvillimin e aftësive specifike në fushën sociale dhe të komunikimit, përfshirë dhe gjuhën e huaj. Në këtë program studimi, studentët kanë edhe një lëndë jo teknike që është ajo e gjuhës Angleze</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor],</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e IAL, në fund të çdo semestri analizohen dhe rishikohen kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në syllabuset e lëndëve të programit të studimit. Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze janë mjete që zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët.</p> <p>Analiza që në tërësi, shqyrtohen nga njësia bazë dhe më pas bëhen pjesë e diskutimeve në senatin akademik, përpara fillimit të vitit të ri akademik.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidence shtese Silabuse elektronike], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë]</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se procesi mësimor realizohet me objektivin kryesor që tu japë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. Institucioni ka garantuar një numër të larmishëm laboratorësh, laboratorë të cilët janë të mirëfilltë didaktik si ato të siguruar nga prodhuesi "Polytech" i cili paraqet edhe argumentet teorik dhe praktik të nevojshëm për përvetësimin e kompetencave praktike.</p>

<p>mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka siguruar edhe laborator të ngritur së fundmi edhe në bazë financimesh nga pjesëmarrje në projekte si ai “Smart Lab” e të tjerë.</p> <p>GVJ vizitoi dhe konstatoi se studentët e programit të studimit Profesional në “Elektronikë” kanë në tërësi laboratorët dhe pajisjet e nevojshme për të zhvilluar laboratorët dhe vënë në praktikë projektet edhe dijet e tyre.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi kanë mundësi të zhvillojnë nga ana praktike njohuri të marra dhe jashtë orëve të dedikuara për aktivitetet laboratorike, duke u organizuar me pedagogët përgjegjës të bazës laboratorike për të realizuar projekte individuale apo në grup edhe në kuadër të “KPT Hub”.</p> <p>Studentët zhvillojnë edhe praktika profesionale si një lëndë e programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës.</p> <p>[Evidenca 5.3 Plani mësimor], [Evidenca 6.5 NASA hackathon konkurse], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 20 KPT HUB], [Evidenca 21 Trajnime studentë], [Evidenca 22 Laboratorët], [Evidenca 26 Trajnimi polytech EU masterclass], [Evidenca 33 Lista e partnerëve. Marrëveshje të bashkëpunimit], [Evidence shtese Cv stafi akademik efektiv], [Evidence shtese Cv stafi akademik me kohe te pjesshme], [Evidence shtese kapacitetet infrastrukurore], [Evidence shtese Labororet Elektronike]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të lëndës, personeli akademik krahas zhvillimit të mësimin të parashikuar në auditor, organizon dhe zhvillon leksione/seminare të hapura me pjesëmarrjen e studentëve. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit dhe workshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi në fushën ku ata studiojnë. Personeli akademik organizon dhe zhvillon mësim të hapura për studentët me industrinë dhe biznesin mbi zhvillimet e reja të teknologjisë në fushën e studimit, ku ftohen dhe marrin pjesë ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p> <p>[Evidenca 11 Lista e projekteve], [Evidenca 11.1 Workshop online USIA, MOVET], [Evidenca 11.2 MOVET desing thinking workshop], [Evidenca 11.3 USIA roundtable USIA], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 25 Mësimi online. Zyra IT video tutorial. Manual Komunikimi], [Evidenca 49 Prezantimet në departament]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i organizuar me një ndarje të aktiviteteve</i></p>

	<i>teorike dhe atyre praktike në një masë rreth 1:1 (50% më 50%) duke mundësuar rritjen e aftësive profesionale. Institucioni mundëson, përtej aktiviteteve të parashikuara laboratorike, edhe përdorimin e bazës laboratorike nga studentët për realizim të projekteve apo ideve të tyre inovatore me mbështetjen e stafit akademik dhe administrativ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL që institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Procedura specifike për provimin final ose mbrojtjen e diplomës u vihet në dispozicion para diplomimit të studentëve së bashku me një fond pyetjesh për orientim. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës ku studentët me rezultate më të larta, kanë mundësinë të zgjedhin të mbyllin ciklin e studimeve me punim diplome.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidenca 50 Programi dhe model teze PPP]</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, dhe në veçanti personeli akademik, asistojnë studentët me informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së diplomës. Gjithashtu njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, pajis studentët me dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Takimet me koordinatorin e programit në veçanti, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit/provimit si dhe mbrojtjes së diplomës. Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës koordinatori i programit të studimit në përfundim të semestrit të parë u shpërndan studentëve fondin e pyetjeve për provimin e formimit që ndërtohen në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit. Në rastin e diplomës, çdo pedagog që caktohet udhëheqës i temës së diplomës punon me studentin e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur duke u</p>

	<p>rekomanduar të gjitha materialet që mund të ndihmojnë studentin të realizojë punimin e diplomës.</p> <p>[Evidenca 41 E-mailet njoftuese nga koordinatorët], [Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidenca 41 E-mailet njoftuese nga koordinatorët], [Evidenca 50 Programi dhe model teze PPP]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloren e KPT, është e përcaktuar se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura për të testuar njohuritë e lëndëve teknike që studentët kanë ndjekur gjatë këtij programi studimi. Përqindja e secilit prej grup pyetjeve përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> <p>Komisioni i provimit përgatit tezën për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>[Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidenca 50 Programi dhe model teze PPP]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Stafi akademik përfshihet në konsultimin për provimin e përgjithshëm përfundimtar sipas një orari të caktuar dhe të bërë publik për studentët. Kryetari i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar organizon dhe ndjek orarin e konsultimit të realizuar nga pedagogët e secilit argument.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën, si dhe staf ndihmës për ti asistuar në kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Personeli akademik dhe ndihmës akademik ndihmojnë studentët në zhvillimin e pjesëve praktike të punimeve të tyre të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>[Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale], [Evidenca 5.2 Raporti i praktikave], [Evidenca 5.4 Dosja e praktikës], [Evidenca 17 Tutoriatet këshillimit akademik], [Evidenca 17.1 Rregullore tutoriati], [Evidenca 18 Vizita praktike në terren], [Evidenca 19.1 Kërkimi i aplikuar], [Evidenca 20 KPT HUB], [Evidenca 21 Trajnime studentë], [Evidenca 22 Laboratorët], [Evidenca 34.1 Infrastruktura IT] [Evidenca 41 E-mailet njoftuese nga koordinatorët], [Evidenca 27 Manuali i studentit]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomës vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidatet dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të ngritura nga komisioni. Nota i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i tij.</p> <p>Në rastin e provimit përfundimtar, nota del pas vlerësimit të çdo</p>

	<p>tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për grup-pyetje brenda fushës së tij të ekspertizës.</p> <p>[Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike, nënshkruhet nga Drejtuesi i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, nënshkruhet nga rektori dhe vuloset me vulën e KPT.</p> <p>Diploma lëshohet vetëm një herë, dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që administrohet nga QSHA (Qendra e Shërbimeve të Arsimit).</p> <p>[Evidenca 3 Statuti], [Evidenca 4 Rregullorja KPT], [Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit], [Evidenca 40 Miratimi i mobilitetit të diplomës. Modeli i diplomës]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, përveç sistemit elektronik në përdorim nga sekretaria mësimore, në funksion të qëllimit të saj administrativ, ruan dhe plotëson dokumentacionin themeltar të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Në veçanti, institucioni plotëson dhe ruan tre regjistra kryesor me të dhëna të plota të studentëve, arritjet e tyre akademike deri në diplomim.</p> <p>Regjistrat e më sipërm, janë sipas formatit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe plotësimi i tyre realizohet në përputhje të udhëzimeve përkatëse të detajuar nga po kjo ministri.</p> <p>Institucioni ka detyrimin ligjor, që në përfundim të kohës së parashikuar të mbajtjes së këtyre regjistrave pranë institucionit, ti depozitojë ato pranë arkivave të shtetit, duke mbajtur pranë institucionit, një kopje të njehsuar me origjinalin. Nga ku mund të nxirret çdo informacion i nevojshëm për studentët që kanë frekuentuar këtë institucion.</p> <p>[Evidenca 45 Regjistri bazë, Themeltar], [Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike], [Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka përcaktuar qartë rregulloret për diplomimin e studentëve (me diplomë ose provim përfundimtar), përfshirë këtu edhe mënyrën e vlerësimit.</i></p> <p><i>Institucioni mban dhe pajis studentët me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke përfshirë diplomën sipas formatit të miratuar dhe me numër unik, regjistrat themeltar, atë të avancimit akademik dhe atë të diplomimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KPT ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative referuar natyrës dhe fushës specifike të studimeve, lëndëve dhe moduleve të programeve të studimit. KPT përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies, sidomos atë laboratorike, për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie. KPT ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme sipas nevojave të njësive bazë si nga zyra e IT për përdorimin e infrastrukturës IT si online gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov2, ashtu edhe në auditor. Gjithashtu, institucioni parashikon edhe në syllabuset e lëndëve aktivitete laboratorike të bazuar në zhvillimet më të fundit teknologjike në fushën e elektronikës dhe në tërësi të teknologjisë së informacionit.</p> <p>[Evidenca 25 Mësimi online. Zyra IT video tutorial. Manual Komunikimi], [Evidenca 27 Manuali i studentit], [Evidenca 28 Manuali classter], [Evidence shtese Silabuse elektronike]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka të përcaktuar qartë se struktura përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë, Departamenti. Në nivelin e njësisë bazë, mësimdhënia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht nga drejtuesi i njësisë bazë si dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në bazë të RVB, dokumenteve të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të drejtpërdrejta nëpërmjet asistimit në sallë nga strukturat e larta të njësisë bazë dhe rektorati; - vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve; - nëpërmjet një strukture studentore të quajtur focus-group; - vetëvlerësimi;

	<p>– Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori.</p> <p>[Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studentë], [Evidenca 29 Manuali i burimeve njerëzore], [Evidenca 29.3 Vendimi i rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv], [Evidenca 29.4 Vendimi i rektoratit për miratimin e stafit me kohë të pjeshme], [Evidenca 36 Raporti vjetor], [Evidenca 49 Prezantimet në departament]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Statuti i KPT dhe rregulloret e tij, kanë të përcaktuar departamentin si përgjegjës për sigurimin e cilësisë së programeve që mbulon. Në të njëjtën kohë KPT ka të ngritur edhe NJSBC që ka detyrë specifike monitorimin e cilësisë në mësimdhënie, si dhe rekomandon dhe ndjek marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Rezultatet e vlerësimit përpunohen nga NJSBC, dhe nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të KPT, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga drejtuesi i njësisë bazë ku analizohen rezultate dhe merren masa për përmirësimet e nevojshme. Staf i akademik vihet në dijeni rast pas rasti dhe problematikat adresohen në departament. Rezultatet e pyetësorëve të përmbledhura jepen në raportet vjetore të hartuara nga NJSBC. Këto raporte nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të institucionit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL duhet të bëjë publike në faqen web zyrtare, rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave.</i></p> <p>[Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC], [Evidenca 13.2 Raporti NJSBC]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës, dhe njësitë bazë përbërëse të tij, përdorin rezultatet e vlerësimeve periodike të hartuara nga NJSBC si dhe nga vlerësimet e drejtë për drejta në ndjekjen e stafit akademik, për të njohur situatën e zhvillimi të të gjithë aktivitetit didaktik, dhe administrativ në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të përmirësimit të tij.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka një staf akademik të qëndrueshëm në vite, çka ka sjellë edhe një njohje më të mirë jo vetëm të aktiviteteve didaktike nga stafi, por në tërësi të objektivave formuese që studentët duhet të përvetësojnë me përfundimin e këtij cikli studimi.</p> <p>Stafi është trajnuar vazhdimisht me institucionet partnere në kuadër të rritjes së aftësive në mësimdhënie dhe zhvillimin e praktikave laboratorike, si me zhvillimin e leksioneve të hapura, seminareve workshope, ashtu edhe me vizita trajnuese në institucionet partnere jashtë vendit.</p> <p>Institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me institucione ndërkombëtare</p>

	për mobilitete të stafit dhe studentëve. [Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite], [Evidenca 6.2 Veprimtaritë e stafit në kuadër të projekteve trajnimeve]			
Konkluzione	<i>KPT ka procedura dhe njësi të dedikuara për monitorimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu ka mbështetur trajnimet e vazhdueshme të stafit në kuadër të përmirësimit të aftësive mësimdhënëse dhe ature praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik, pasi i gjithë stafi akademik efektiv ka së paku diploma Master i Shkencave ose Master i Nivelit të Dytë, nga Master Profesional që parashikon ligji. Drejtuesi i programit të studimit, drejtuesi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit ka titullin akademik Profesor.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, ka ekspertizën e nevojshme për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>DTI tregon kujdes që në fazën e rekrutimit të PAE ose PAK duke vlerësuar eksperiencën në punë, institucionin ku është shkolluar kandidati, motivimin që ai paraqet në lidhje me mësimdhënien,</p>

	<p>rezultatet individuale profesionale etj.</p> <p>[Evidencë shtesë CV stafi akademik efektiv], [Evidencë shtesë CV stafi akademik me kohë të pjesshme], [Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv angazhuar për programin e studimit profesional në “Elektronikë” mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të sanksionuar me aktet e brendshme rregullatore të KPT (Vendim Senati Akademik) dhe të shprehur në kontratën individuale të punës që PAË ka me institucionin. Nga të dhënat që paraqiten për ngarkesën mësimore të PAE, nuk vihet re asnjë mbingarkesë, madje ka raste edhe nën ngarkimi.</p> <p>[Evidenca Nr. 29.3- Vendimi i Rektoratit për caktimin e ngarkesës mësimore për stafin akademik], [Evidenca Nr. 29.1- Dosja e Personelit], [Evidenca Nr. 29.2- Kontrata tip e punës]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>DTI në KPT dëshmon një qëndrueshmëri në përbërjen e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, pasi vihet re se stafi akademik efektiv ka ndryshime të vogla dhe ato janë kryesisht në zvogëlimin e numrit. Kjo lidhet me një faktor objektiv, siç është zvogëlimi i numrit të studentëve në këtë program studimi. Madje dy vitet e fundit, në këtë program studimi nuk ka student të regjistruar. Kjo qëndrueshmëri, edhe pse në kushte jo të mira në aspektin e prurjeve të reja, është për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore në mbështetje të plotë me ligjet në fuqi.</p> <p>Sipas përcaktimeve në Statutin e KPT, personeli akademik ka të përcaktuar veç të tjerash në kontratën individuale me institucionin edhe formën e angazhimit dhe kohëzgjatjen e kontratës.</p> <p>[Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite], [Evidenca 32. Detyrimet në kohë reale. Paga e kontributeve], [Evidenca 3. Statuti I KPT]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i procedurave të punësimit për personelin akademik dhe ndihmës akademik të programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë” në KPT, del e qartë se Zyra e Burimeve Njerëzore zbaton procedura që parashikohen në Rregulloren dhe Statutin e KPT, Manualin e Burimeve Njerëzore të KPT dhe në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedura fillon me marrjen e kërkesës prej departamentit që ka vend vakant (kërkesa i drejtohet Rektorit të KPT), shoqëruar me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përzgjedhjes dhe pranimit së kandidatit dhe grupin e lëndëve që ka interes DTI. Vendi vakant shpallet në faqen web të KPT sëbashku me kriteret e përzgjedhjes së kandidatit. Më pas me konkuresit që kanë dorëzuar dosjen personale me dokumentacionin e kërkuar, zhvillohet një intervistë me komisionin e vlerësimit si dhe orë e hapur në formë leksioni mbi çështjet me interes të lëndës që kandidati do të zhvillojë, i</p>

	<p>cili më pas merr vendimin. Nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore bëhet njoftimi përfundimtar për rezultatin e konkursit tek kandidatët pjesëmarrës.</p> <p>Aktet e brendshme rregullatore të KPT kanë të shprehura procedurat dhe kriteret e përgjithshme për rekrutimin e personelit akademik.</p> <p>Kriteret specifike të rekrutimit shprehen prej njësisë bazë në përputhje me nevojat që ka. Këto kriteret specifike i bëhen me dije Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe kjo e fundit i bën publike në njoftimin e bërë në faqen web të KPT.</p> <p>[Evidenca Nr. 29- Manuali i Burimeve Njerëzore], [Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>KPT dhe DTI duke ndjekur një procedure përzgjedhjeje dhe punësimi transparente dhe të detajuar në aspektin e kriterëve për kandidatët, siguron zbatimin e parimeve të paanshmërisë dhe meritokracisë në rekrutimin e PAE/PAK me qëllim garantimin e angazhimit të personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) realizimin e orëve laboratorike 2) për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. <p>Nga vëzhgimi i laboratorëve vihet re se personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhuar me laboratorët, kryen punë të mire në pasurimin e laboratorëve me objekte (pajisje elektroshtëpiake të dëmtuara, për riparim) në ndihmë të temave praktike të zhvilluara si dhe përfshirjen e studentëve në këtë pasurim, me qëllim rritjen e interesit dhe të rëndësisë praktike të lëndëve që zhvillojnë.</p> <p>[Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>KPT ka pjesë të strukturës Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave e cila mban përgjegjësi për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë në programin e studimit dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar. Kjo strukturë vepron në nivel institucioni.</p> <p>Nga takimi me anëtarët e kësaj zyre dhe verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit që kjo drejtori ka në administrim, u vu re se dokumentacioni për stafin akademik të rekrutuar bëhet konform ligjit dhe konform akteve rregullatore të brendshme të KPT. Në dosjen individuale të personelit akademik, përveç dokumentacionit të dorëzuar në pranimin e tij në institucion, janë edhe kontratat e punës me afat të pacaktuar.</p> <p>Procedurat e ndjekura nga strukturat e KPT për rekrutimin e personelit akademik vlerësojnë kandidatët e interesuar mbështetur në kriteret të</p>

	<p>përgjithshme dhe specifike, të cilat publikohen dhe synojnë të përzgjedhin personel akademik me kualifikimin e duhur, sidomos përvojën praktike të tij dhe në përputhje me natyrën e përmbajtjen e programit të studimit dhe lëndëve që do të zhvillojë.</p> <p>[Evidenca Nr. 29- Manuali i Burimeve Njerëzore], [Evidenca Nr. 29.1- Dosja e Personelit], [Evidenca Nr. 29.2- Kontrata tip e punës]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KPT në mbështetje të programit të stumit me karakter profesional në “Elektronikë” ka marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani me qëllim kryerjen e praktikave profesionale jo vetëm në ambientet laboratorike që DTI ka ndërtuar. Në praktikat profesionale që studentët kryejnë gjatë semestrit të dytë në vitin e dytë akademik, prej 6 javësh, DTI angazhon personel akademik PAE ose PAK në rolin e mbikqyrësit të praktikës, të mjaftueshëm dhe të duhur, në përputhje me kualifikimet e tyre, për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p>Sipas rregullores së praktikës profesionale, studentit I caktohet dhe një mbikqyrës nga institucioni/biznesi pritës, që shërben si pike kontakti për ecurinë e praktikës. Në fund të praktikës, nga DTI organizohet procedura e përmbylljes së praktikës, ku studenti harton një relacion teknik dhe prezantim, sipas një guide të bërë me dije më parë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e praktikës profesionale.</p> <p>[Evidence 33. Lista e partnerëve/marrveshjeve të bashkëpunimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale], [Evidenca 5 Rregullorja e Programit të studimit]</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në rregulloren e praktikave profesionale, DTI përcakton se është e detyrueshme që të caktohet personel mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve. Ky mbikqyrës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve teknike dhe administrative gjatë zhvillimit të praktikës, udhëzon në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale në DTI/KPT.</p> <p>[Evidence 33. Lista e partnerëve/marrveshjeve të bashkëpunimit], [Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DTI në KPT ka personel akademik dhe ndihmës akademik, të angazhuar në realizimin e programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë”, që përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik, pasi i gjithë stafi akademik efektiv ka së paku diploma Master i Shkencave ose Master i Nivelit të Dytë, nga Master Profesional që parashikon ligji, me ekspertizën e nevojshme për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e</i></p>

	<p><i>moduleve të tij.</i></p> <p><i>KPT dhe DTI duke ndjekur një procedure përzgjedhjeje dhe punësimi transparente dhe të detajuar në aspektin e kriterëve për kandidatët, siguron zbatimin e parimeve të paanshmërisë dhe meritokracisë në rekrutimin e PAE/PAK me qëllim garantimin e angazhimit të personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</i></p> <p><i>DTI angazhon personel akademik PAE ose PAK në rolin e mbikqyrësit të praktikës, të mjaftueshëm dhe në përputhje me kualifikimet e tyre, për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Sipas rregullores së praktikës profesionale, studentit i caktohet dhe një mbikqyrës nga institucioni/biznesi pritës, që shërben si pike kontakti për ecurinë e praktikës. Në fund të praktikës, studenti harton një relacion teknik dhe prezantim, sipas një guide të bërë me dije më parë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e praktikës profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KPT ka vënë në dispozicion të programeve të studimit që zhvillon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si nga ana logjistike ashtu dhe në drejtim të sigurisë. Ambientet e klasave/zyrave/ambientet e përbashkëta: korridore, tualete etj, janë me hapësira të mjaftueshme në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore. Ambientet janë me dritë, të ajrosura, të mirëmbajtura, të larta, pajisur me mjetet e sigurisë kundër zjarrit vendosur në vende të dukshme, me skemat e evakuimit etj. KPT ka 5 ambiente që përdoren si laboratore/ofiçoinë e pajisur në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Klasat janë të pajisura me projektorë e kompjutera të përshtatshëm për egzekutimin e softeve inxhinierike.</p> <p>[Evidenca 22. Labororët], [Evidenca 34. Infrastruktura], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të</p>	<p>Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, ofiçina, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë</p>

<p>tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjiave e teknologjiave bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjiave e teknologjiave bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) klasat janë të përcaktuara sipas madhësisë për leksione/seminare/laboratore. Ato kanë videoprojektorë e kompjutera, për zhvillimin e mësimin në mënyrë të kombinuar. Ka infrastrukture IT të ngritur e të mirëmbajtur, që siguron internet e WiFi në të gjithë ambientet e KPT. Numri i ulëseve është deri në 25 për klasat e seminareve. KPT ka në përdorim edhe një sallë konferencash të mirëpajisur për zhvillimin e takimeve shkencore e prezantimeve në nivel institucioni. 2) labororet kanë kapacitete të mjaftueshme për ndërtimin e posteve të punës për 10-12 studentë. Janë të pajisura mirë me mjete didaktike por edhe me risitë teknologjike në lidhje me automatizimin e ndërtesave dhe industrisë. 3) KPT ka 4 laboratorë me kompjutera me 25 poste secili, me internet e sinjal WiFi, me 2 rack-e të lëvizshme, laptopë të pajisur me software të duhur për zhvillimin e orëve mësimore në përputhje me kërkesat e programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë” <p>[Evidenca 22. Laboratorët], [Evidenca 34.1. Infrastruktura IT], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>KPT dhe DTI ka vendosur në dispozicion të programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë” laboratorë dhe baza praktike profesionale dhe oficinë të pajisura mire në përshtatje me natyrën specifike të programit. Këto ambiente përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme didaktike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Konkretisht, në laboratore ka module bashkëkohore për zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e elektronikës analoge, elektronikës digjitale, mikroelektronikës, ndërtimi dhe funksionimi i sistemeve të automatizuara në ndërtesa e industri (komandimi me mikrokontrollera dhe operimi me PLC etj), kontroll e menaxhim në distance të rrejtave të sigurisë kundër zjarrit, vëzhgimit me kamera, sistemeve antivjedhje, sistemeve të menaxhimit të hyrje daljeve, etj.</p> <p>[Evidenca 22. Laboratorët], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>KPT dhe DTI ka siguruar 4 laboratore të teknologjisë së informacionit, të pajisur me 25 kompjutera secili ku janë instaluar programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron: DevC++, Raptor, Paketa Office, plotësisht të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Gjithashtu ka në dispozicion të këtyre laboratoreve edhe 1 pool me 15 laptopë për kryerjen e detyrave të veçanta në</p>

	funksion të programit mësimor. [Evidenca 22. Laboratorët], [Vizita në institucion]			
Konkluzione	<i>KPT ka vënë në dispozicion të programeve të studimit që zhvillon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si nga ana logjistike ashtu dhe në drejtim të sigurisë. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, ofiçina, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (module bashkëkohore dhe sisteme elektronike të përditësuara me përdorim rezidencial e industrial), që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Personeli akademik I DTI që zhvillon lëndët në programin e studimit profesional në “Elektronikë” ka vendosur në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, që përcaktohet edhe në syllabuset përkatëse. Përveç tekstve mësimore në shqip ose anglisht sipas rastit, secili pedagog ka përgatitur leksione të shkruara (që i janë nënshtruar një reçence paraprake nga DTI) që iu jepen studentëve në formë elektronike ose kopje fizike, me qëllim garantimin e marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme dhe të përditësuara, të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Literatura bazë dhe ajo e rekomanduar përgjithsisht gjendet në bibliotekën që KPT, në sja të bashkëpunimit me Universitetin Europian të Tiranës, ka ofruar për programet e saj të studimit një library online me më shumë tituj për secilën kategori studimore.</p> <p>KPT ka krijuar OER (Open Educational Resource), i aksesueshëm për të gjithë studentët dhe PAE e PAK ku aksesohen pa kufizime materialet mësimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit, me një liçencë të hapur.</p> <p>[Evidenca 34.4 Biblioteka online], [Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Vizita në institucion]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë	KPT ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e cila ka krijuar kushte të përshtatshme për studim dhe jep mundësinë e

<p>e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit profesional në “Elektronikë”. Falë rregullores së funksionimit të bibliotekës dhe pajisjes së studentëve me kartën e bibliotekës, studentët aksesojnë literaturën e nevojshme sipas orareve të shpallura, sipas përcaktimeve të Statutit të KPT.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti I KPT], [Evidenca 34.4 Biblioteka online], [Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Evidenca 34.3 Kartë e bibliotekës], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KPT është e pajisur me fond fizik tekstesh mësimore bazë, literaturë ndihmëse dhe leksione të shkruara. Tekstet mësimore janë në numër të mjaftueshëm, në gjuhën shqipe dhe të huaja. Nga karakteri që ka ky program studimi, është domosdoshmri përditësimi i vazhdueshëm i literaturës, prandaj përveç librave fondi i bibliotekës pasurohet edhe me revista shkencore të nevojshme ku KPT është pajtuar, me qëllim mbulimin e të gjitha kërkesave të moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>DTI evidenton vazhdimisht nevojat që personeli akademik ka për pasurimin e fondit të bibliotekës përmes blerjeve ose huazimeve.</p> <p>[Evidenca 34.4 Biblioteka online], [Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KPT falë bashkëpunimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Shtetërore dhe Bibliotekën Kombëtare ka mundur pa pagesë për studentët dhe personelin akademik librarinë online <i>openlibrary.org</i> duke krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. Gjithashtu ka mundur aksesimin e një numri më të madh tekstesh e manualesh teknike përmes platformës online <i>Sharefolder</i> vetëm nga kompjuterat e KPT.</p> <p>[Evidenca 34.4 Biblioteka online], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>KPT dhe DTI mundëson për studentët një biblioteka të jetë e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, internet, akses në libraritë online, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe personelin akademik/ndihmës akademik e administrativ. Funksionimi i bibliotekës bëhet mbi bazën e një rregulloreje dhe orari të shpallur, për të cilën studentët kanë njoftim.</p> <p>[Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>KPT e ka rregulluar veprimtarinë e bibliotekës me rregullore të veçantë dhe ka përcaktuar në statut oraret e funksionimit të saj. Oraret e bibliotekës janë të shpallura në ambientet e KPT dhe janë të mjaftueshme, pasi në 5 ditë të javës funksionon me dy turne (9.00-20.00) dhe e shtuna 9.00-17.00. KPT mundëson që gjatë sezonit të provimit orari i bibliotekës të zgjatet më tej, sipas kërkesës së studentëve. Ky orar u mundëson studentëve përdorimin e ambienteve</p>

	<p>të bibliotekës në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> <p>[Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekës], [Vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Nga vizita në institucion u gjet se DTI bën përpjekje që biblioteka të raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. Në materialet që ndodhen në DVV del në dukje përpjekja që bëhet për pasurimin e bibliotekës me literaturë fizike të përditësuar.</p> <p>[Vizita në institucion], [Evidenca 36. Raporti vjetor]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik i DTI që zhvillon lëndët në programin e studimit profesional në “Elektronikë” ka vendosur në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, që përcaktohet edhe në syllabuset përkatëse. Përveç teksteve mësimore në shqip ose anglisht sipas rastit, secili pedagog ka përgatitur leksione të shkruara (që i janë nënshtruar një reçence paraprake nga DTI) që iu jepen studentëve në formë elektronike ose kopje fizike, me qëllim garantimin e marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme dhe të përditësuar, të parashikuara në programin e studimit.</i></p> <p><i>KPT dhe DTI mundëson për studentët një bibliotekë të pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, internet, akses pa pagesë në libraritë online, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe personelin akademik/ndihmës akademik e administrativ. Funksionimi i bibliotekës bëhet mbi bazën e një rregulloreje dhe orari të shpallur, të mjaftueshëm dhe në përputhje me orarin e mësimin (funksionim me 2 turne në 6 ditë të javës), për të cilën studentët kanë njoftim. KPT ka dokumentuar përpjekjen që bën për pasurimin e bibliotekës me literature fizike të përditësuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>		<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>KPT disponon sistem të menaxhimit të informacionit të brendshëm që ka lidhje me të gjitha aspektet e punës së institucionit: administrative, sekretaria mësimore, akademike. Kjo realizohet përmes platformës së menaxhimit të informatizuar që KPT ka ndërtuar përmes kontratës me shoqërinë Tech360, përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aplikacioneve në Classter, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p> <p>[Evidence 28/1 Sistemi Classter]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit që KPT ka në përdorim, administron</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) informacionin në shërbim të studentëve për oraret e mësimit, bibliotekën, provimet etj 2) dokumentacionin (kopje fizike dhe digjitale), për aktivitetin akademik dhe për personelin akademik 3) aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, sekretarëve mësimore, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. <p>Ka informacione në lidhje me projektet ku pedagogët mund të përfshihen etj</p> <p>[Evidence 28/1 Sistemi Classter], [Evidence 28 Manualii Classter]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit që KPT përdor (Sistemi Classter) dhe platforma Microsoft, kanë qasje bazuar në përdorues/fjalëkalim, duke siguruar akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Aksesit mbi informacionet e menaxhuara bazohet në privilegjet dhe hierarkinë e përdoruesve dhe vjen në 3 forma të ndryshme me qëllim lehtësimin e komunikimit të pedagogëve me studentët dhe shkëmbimin e materialeve didaktive, detyra të studentëve etj.</p> <p>[Evidence 28 Manuali Classter], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar 2 platforma: Classter dhe Microsoft Teams si dhe modulet përkatëse që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Përmes këtyre platformave mund të zhvillohet mësim online, shkëmbime materialesh diaktike, dorëzime detyrash, informacion për orarin e mësimit, orarin e provimeve, rezultatet e provimeve etj.</p> <p>[Evidence 28 Manuali Classter], [Evidence 28/1 Sistemi Classter]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ</p>	<p>Sistemi i menaxhimit që KPT disponon, realizon monitorim në kohë reale të:</p>

dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<ol style="list-style-type: none"> 1) aktivitetit akademik në ndihmë të personelit akademik dhe studentëve me informacione në lidhje me procesin mësimor ; 2) aktivitetit administrativ në lidhje me sekretarinë mësimore dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për Departamentet dhe organet drejtuese. <p>[Evidence 28 Manuali Classter], [Evidence 28/1 Sstemi Classter]</p>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në funksionim faqen zyrtare online https://kolegjiprofesional.edu.al</p> <p>Në këtë faqe gjenden informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të programit të studimit, aktivitetet e ndryshme studentore dhe akademike, struktura organizative e KPT etj. Kjo faqe përditësohet dhe mirëmbahet sistematikisht sipas një politike menaxhuese të brendshme të institucionit.</p> <p>[Evidenca 35 Politika e menaxhimit/mirëmbajtjes së faqes së internetit]</p>								
Konkluzione	<p><i>KPT disponon sistem të menaxhimit të informacionit të brendshëm që ka lidhje me të gjitha aspektet e punës së institucionit: administrative, sekretaria mësimore, akademike. Kjo realizohet përmes platformës së menaxhimit të informatizuar Classter, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. Gjithashtu përmes platformës Microsoft Teams realizohet shkëmbim materialesh didaktike midis pedagogëve dhe studentëve, mësim online etj. Qasja në këto platforma bëhet me akses të dedikuar.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>KPT harton një raport financiar të kostove në rang institucioni. Ky raport financiar nuk bëhet sipas njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit bëhet gjithashtu mbi bazë institucioni për një cikël të plotë studimi dhe bazohet kryesisht tek tarifat e shkollimit, të ardhura nga projektet (5 projekte Europiane sipas Raportit Vjetor 20-21), nga donacionet e partnerëve dhe aktivitetet për të tretë. Të dhënat në lidhje me raportin financiar</p>

	<p>paraqiten në raportin vjetor.</p> <p>[Evidenca 36 Raporti vjetor]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit hartohet mbi bazë institucioni dhe jo mbi bazë të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Në këtë plan përfshihen kostot për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Mbi bazën e këtij plani financimi dhe shpenzimeve përcaktohen edhe tarifat e shkollimit për çdo program studimi, të cilat raportohen në Raportin Vjetor të KPT dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të KPT.</p> <p>KPT analizon dhe llogarit koston për KPT si institucion dhe për secilin program studimi bazuar mbi metodologjinë e shpenzimeve në total: shpenzimet totale të Departamentit/numrin total të studentëve në program studimi.</p> <p>[Evidenca 36 Raporti vjetor]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>KPT kryen dhe rregullon aktivitetin financiar përmes Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPT. Një pale e tretë, e pavarur kryen auditim periodik (çdo vit), vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të KPT.</p> <p>[Evidenca 32 Detyrimet në kohë reale/Pagesa e kontributeve]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>KPT raporton në nivel institucional në lidhje me aktivitetin financiar si dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare që ky institucion ka në lidhje me realizimin e programeve të studimit. Nëse i referohemi njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “diplomë profesionale në Elektronikë” ka vështirësi për vlerësimin e realizimit të buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe parashikimin për vitet në vijim, sepse prej dy vitesh akademike ky program studimi nuk ka asnjë regjistrim të ri. Kjo e bën perspektivën e zhvillimit të këtij programi studimi të paqartë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DTI ka punuar në drejtim të rritjes cilësore të infrastrukturës laboratorike me qëllim që studentët e programeve të studimit që ajo zhvillon të pajisen me dije dhe aftësi praktike për profesionin që duan të përvetësojnë. Kjo mundësohet prej KPT që ka qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programeve të studimit të DTI dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</p> <p>Nga ana e institucionit është investuar në një program studimi për të cilin tregu i punës ka nevojë të madhe, në një program studimi me infrastrukture të kompletuar dhe të përditësuar, me personel akademik me përvojë profesionale edhe në kushtet që numri i</p>

	<p>studentëve nuk ka qenë tepër i lartë (madje dy vitet e fundit nuk ka regjistrime të reja). KPT mund të kërkojë forma të tjera për promovimin e këtij programi studimi me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve, të cilët duhet të jenë edhe me notë mesatare relativisht të lartë për shkak të nivelit të vështirësisë që ky program studimi ka.</p> <p>[Evidenca 36 Raporti vjetor 20-21], [Vizita në institucion, takimi me Rektorin e KPT dhe Përgjegjësën e Departamentit DTI]</p>
--	--

Konkluzione	<p><i>KPT harton një raport financiar vjetor të kostove në rang institucioni. Ky raport financiar nuk bëhet sipas njërive bazë përgjegjëse për programet e studimit. Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit bëhet gjithashtu mbi bazë institucioni për një cikël të plotë studimi dhe bazohet kryesisht tek tarifat e shkollimit, të ardhura nga projektet (5 projekte Europiane sipas Raportit Vjetor 20-21), nga donacionet e partnerëve dhe aktivitetet për të tretë. Të dhënat në lidhje me raportin financiar paraqiten në raportin vjetor, raportohen në MAS dhe I nënshtrohen auditimit çdo vit .</i></p> <p><i>DTI ka punuar në drejtim të rritjes cilësore të infrastrukturës laboratorike. Kjo mundësohet prej KPT që ka qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programeve të studimit të DTI dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Mbetet shqetësues interesi i ulët që gjimnazistët/nxënësit e shkollave të mesme profesionale kanë për programin e studimit “diplomë profesionale në Elektronikë”. Nga ana e institucionit është investuar në një program studimi për të cilin tregu i punës ka nevojë të madhe, në një program studimi me infrastrukturë të kompletuar dhe të përditësuar, me personel akademik me përvojë profesionale edhe në kushtet që numri I studentëve nuk ka qenë tepër I lartë (madje dy vitet e fundit nuk ka regjistrime të reja). Mbetet të shikohen forma të tjera për promovimin e këtij programi studimi me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve dhe me kualitet sa më të lartë.</i></p>
--------------------	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	<input checked="" type="radio"/>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>KPT ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Ky fakt evidentohet në Statutin e KPT dhe rregulloren e programit të studimit “diplomë profesionale në Elektronikë”. Gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët konfirmoi se procedurat e ndjekura garantojnë barazinë, transparencën dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>[Vizita në KPT Takimi me studentët], [Evidenca 3 Statuti i KPT], [Evidence 5 Rregullorja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit, regjistrimit, mbështetjes me bursa, informimit të vazhdueshëm, vlerësimi dhe diplomimi garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Përcaktimi i kuotave dhe pranimi i studentëve bëhet sipas akteve ligjore në fuqi që njoftohen prej ministrisë përgjegjëse për arsimin, dhe akteve rregullatore të brendshme të KPT.</p> <p>Pranimi bëhet pas aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore U-Albania dhe shpalljes fitues prej KPT të kandidatëve. Fituesit njoftohen në faqen zyrtare të internetit të KPT. Duke qenë se programi i studimit “diplomë profesionale në Elektronikë” është me natyrë profesionale, pranimi i kandidatëve nuk ka kufizime në lidhje me notën mesatare. Informimi në lidhje me koston e programit të studimit, përfitimim e bursave, në lidhje me programin e studimit etj jepet përmes takimeve të stafit me studentët, faqes së internetit dhe guidave studentore. Materialet didaktike u jepen studenteve në format elektronik në klasat digjitale përmes platformës Teams dhe Classter.</p> <p>[Vizita në institucion Takimi me studentët], [Evidence 28 Manuali Classter]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>KPT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve, të cilat miratohen me Vendim Senati Akademik të KPT dhe i njoftohen edhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>KPT bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Regjistrimi i studentëve të pranuar në KPT bëhet pasi ata dorëzojnë</p>

	<p>dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve shpallur në faqen zyrtare të KPT.</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u verifikua se në dosjen e studentëve ndodhen dokumentat e përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe statutin e KPT.</p> <p>[Evidence 23 Vendimet e SA], [Evidenca 3 Statuti i KPT], [Evidence 5 Rregullorja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>KPT ka publikuar në faqen zyrtare të tij në internet Statutin e KPT dhe Rregulloren e Programit të Studimit ku tregohen qartë kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve. Kandidatët studentë të interesuar mund të gjejnë informacion edhe për mundësitë e përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit të studimeve, njohjes së kurseve profesionale të kryera më parë, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Ky informacion është i kuptueshëm dhe i aksesueshme nga publiku. Gjithashtu, KPT javën e parë të semestrit të parë e përdor për informimin e detajuar të studentëve të regjistruar, njohjen me stafin akademik, ambientet etj.</p> <p>[Evidence 30 Java e orientimit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>KPT ka parashikuar në Statutin e KPT, Neni 6, pika 2 (b), kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në lidhje me kandidatët student me aftësi të kufizuara, KPT ka ndërtuar infrastrukture që lehtëson aksesimin e të gjitha ambienteve mësimore e shërbimeve për të gjitha kategoritë. Deri tani në KPT nuk ka patur raste të tilla.</p> <p>[Evidenca 3 Statuti i KPT], [Vizita në institucion, ambientet]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>KPT ka hartuar dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e studentëve të pranuar në programe studimi me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat ofrohen për studentët me notë mesatare të lartë (mbi 9) në hyrje dhe/ose gjatë zhvillimit të studimeve. Sipas raportit vjetor, në KPT nuk ka patur asnjë student që plotësonte kushtin e përfitimit të bursës.</p> <p>[Evidenca 36 Raporti vjetor 20-21]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KPT ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, që garantojnë barazinë, transparencën dhe të drejta të njejta për të gjithë studentët, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. KPT ka parashikuar në Statutin e KPT kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në lidhje me kandidatët student me aftësi të kufizuara, KPT ka ndërtuar infrastrukture që lehtëson aksesimin e të gjitha ambienteve mësimore e shërbimeve për të gjitha kategoritë. KPT ka hartuar dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur</i></p>

	<i>cilësinë e studentëve të pranuar në programe studimi me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat ofrohen për studentët me notë mesatare të lartë (mbi 9) në hyrje dhe/ose gjatë zhvillimit të studimeve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>KPT ka vlerësuar me rëndësi të madhe vënien në dispozicion të studentëve të vet dhe kandidatëve për student informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion ofrohet në mënyra të ndryshme. Kryesisht ky informacion u jepet studentëve nga zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit gjatë javës informuese në semestrin 1, viti I, si dhe nga secili pedagog që zhvillon lëndët e programit të studimit. Këto kritere e procedura gjenden edhe në Statutin e KPT dhe rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu KPT përdor platformën Teams dhe sistemin Classter për shkëmbim informacionesh të ndryshme midis studentëve dhe personelit akademik/sekretarisë mësimore. Gjithashtu Tutoriatet e ngritura mundësojnë marrjen e shpejtë të informacionit dhe zgjidhjen e problematikave që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Në faqen zyrtare të KPT ka të dhëna për programet e studimit, kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit, tarifat e shkollimit, aksesimi në Libraritë online dhe sistemin Classter etj.</p> <p>[Evidencë 3 Statuti i KPT], [Evidencë 4 rregullorja e programit të studimit], [https://kolegjiprofesional.edu.al]</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	<p>KPT i ka të parashikuara në Statutin e KPT dhe Rregulloren e Programit të studimit kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Ky informacion iu jepet studentëve të interesuar gjatë parashtrimit të ofertës akademike nga Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit dhe pasqyrohet edhe në kontratën që nënshkruhet nga KPT dhe studenti në momentin e regjistrimit. Gjatë takimit me studentët u konfirmua se nga ana e KPT ka gadishmëri për dhënie informacioni të plotë në lidhje me këtë çështje.</p> <p>[Evidencë 3 Statuti i KPT], [Evidencë 4 Rregullorja e programit të studimit në KPT], [Vizita në institucion, takimi me studentët]</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>KPT i ka të parashikuara në Statutin e KPT dhe Rregulloren e Programit të studimit kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky informacion, i detajuar u jepet studentëve në javën e parë të mësimit të çdo lënde, sëbashku me informacionin që përmban syllabusi përkatës. Studentët konfirmuan që kishin informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve, mënyrën e zgjidhjes së ankesave të studentëve për vlerësimin etj.</p> <p>[Evidencë 5.5 Syllabuset], [Evidencë 4 Rregullorja e programit të studimit në KPT]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>KPT ka të parashikuara në Statutin e KPT dhe Rregulloren e Programit të studimit (Neni 56) kriteret dhe procedurat për kryerjen e punimit përfundimtar prej studentit dhe diplomimin e tij. Përmes tutoriateve, postës elektronike, noftimeve në ambientet e institucionit, KPT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit, të cilat miratohen nga Senati Akademik i KPT për çdo vit, që mund të jetë një temë diplome ose një provim përfundimtar, në varësi të notës mesatare të dy viteve të studimit. Pas kryerjes së detyrimit përfundimtar me një nga format e miratuara, studenti pajiset me diplomë sipas formatit të aprovuar nga QSHA (diploma profesionale nuk paashikon suplement).</p> <p>[Evidencë 4 Rregullorja e programit të studimit në KPT], [Evidencë 40 Modeli i diplomës, Miratimi nga QSHA]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga takimi me Rektorin/Përgjegjës të Departamentit, u konfirmua se përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, KPT</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) publikon udhëzues të posaçëm në formë fletëpalosjesh ose broshurash me QR code që drejton tek faqja zyrtare e KPT për informacion më të detajuar 2) organizon takime të hapura dhe vizita në KPT për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, gjatë Javës së informimit. 3) organizon panairë/workshope pune dhe studimi 4) organizon ture në gjimnazet e shkollat e mesme për promovimin e programit të studimit. Etj. <p>Pavarësisht përpjekjeve që KPT bën për promovimin e programit të studimit Diplomë profesionale në Elektronikë, prej 2 vitesh ky program studimi nuk ka asnjë student të regjistruar. Ky fakt bën domosdoshmëri përpjekjen e KPT në drejtime të tjera, duke kërkuar ndihmë nga ministria përgjegjëse për arsimin, por edhe ajo e mbështetjes sociale apo instanca të tjera ligjore, për ndryshime të mundshme ligjore që do e bënin më tërheqës dhe të vlerësuar këtë program studimi që përgatit një profesionist për të cilin tregu i punës ka shumë nevojë.</p>

	[Evidencë 24/2 Open Days in KPT], [Evidencë 24/4 Panaiet Work and study], [Evidencë 24/1 Turet], [Evidence 30 Java e orientimit], [Evidenca 17/1 Rregullorja e Tutoriatit]			
Konkluzione	KPT ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen e rezultateve akademike në programe të mëparshme studimi, kriteret e procedurat për vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit, organizon takime të hapura në ambientet e KPT dhe ture në shkollat e mesme për promovimin e programit të studimit. Ky informacion jepet përmes Tutoriateve, zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit, Sistemit Cluster e Platformës Teams, nga personeli akademik, nga njoftimet në faqen zyrtare dhe njoftimeve në ambientet e KPT, në javën e informimit dhe turet në KPT etj. Mbetet të kërkohen forma të tjera promovimi të këtij programi studimi, sepse prej 2 vitesh nuk ka studentë të regjistruar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input checked="" type="radio"/>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e programit të studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë pranuan se janë informuar në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ky informacion gjendet në faqen zyrtare të KPT https://kolegijiprofesional.edu.al/ Këtu mund të gjendet informacion edhe për pranimin, regjistrimin, tarifat e shkollimit, mundësitë e punësimit etj. Këto informacione janë pasqyrim i Vendimeve të Senatit të KPT mbështetur në Udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. [Evidencë 23 Vendimet e Senatit të KPT]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/	KPT ka përgatitur Manualin e Studentit, që informon studentin në lidhjen me jetën studentore në KPT. Gjithashtu, përmes aksesimit në Sistemin Classter KPT ka vënë në dispozicion të studentëve

<p>udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>informacion dhe dokumentacion në formën e udhëzuesve të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion shpjegohet edhe prej personelit akademik respektiv, me qëllim që të kuptohet më mirë prej studentëve. Përmes këtij sistemi studenti merr info edhe për oraret e veprimtarive mësimore, rezultateve akademike, detyrimeve, formularë të ndryshëm, etj</p> <p>[Evidencë 27 Manuali i studentit], [Evidencë 28/1 Sistemi Classter]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në faqen zyrtare të KPT ka informacion për studentët mbi mundësitë e punësimit. Panairët e punës dhe studimit që KPT organizon periodikisht, ofrojnë mbështetjen institucionale për orientimin e studentëve drejt dhe në tregun e punës. Gjithashtu, Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit në bashkëpunim me Departamentin DTI organizon takime me bizneset dhe praktikantët mësimore të studentëve tek partnerët dhe bizneset me të cilat ka kontrata e marrëveshje bashkëpunimi dhe përpiqet të krijojë ura bashkëpunimi në shërbim të punësimit të tyre menjëherë pas përfundimit të studimeve dhe në përputhje me diplomën. Tregohet kujdes që njoftimet e punësimit të bëhen të dukshme në forma të ndryshme: në faqen zyrtare të KPT, në rrjetat sociale të KPT, në këndin e njoftimeve në KPT dhe në email-et e studentëve.</p> <p>Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me informacionin për çdo student: arritjet akademike, punësimin, ecurinë e karrierës, përmes lidhjeve të vazhdueshme me ta, edhe pas diplomimit.</p> <p>[Evidencë 12 Sondazhi Alumni], [Evidenca 33 Lista e partnerëve, marrëveshje], [Evidenca 31 Takime me biznese], [Evidenca 44 Thirrje, Nofime punësimi]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve që pranohen dhe regjistrohen në programin e studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë iu vihet në dispozicion përmes Sistemit Classter një informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Pjesë e këtij informacioni gjendet edhe në faqen zyrtare të internetit të KPT. Gjithashtu, secili anëtar i personelit akademik informon në kohën e duhur studentët për procesin mësimor, labororet dhe ambientet e tjera në shërbim të procesit mësimor.</p> <p>[Evidenca 30 Java e informimit], [Evidenca 5.5 Syllabuset]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikantët profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e</p>	<p>Studentët në KPT informohen prej Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit mbi praktikantët profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit. Ky informacion jepet në kohë /etapa të ndryshme të ecurisë së tyre: në hyrje gjatë javës së Informimit dhe në prag të praktikës profesionale, ku njihen me partnerët dhe institucionet bashkëpunuese të KPT, ku parashikohen të realizohen praktikantët profesionale, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Studentët</p>

në tregun e punës.	njoftohen vazhdimisht, përmes mjeteve të ndryshme, në lidhje me ofertat e punës, sipas specialiteteve. [Evidenca 33 Lista e partnerëve, marrëveshje], [Evidenca 31 Takime me biznese], [Evidenca 44 Thirrje, Noftime punësimi]			
Konkluzione	<i>KPT ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënitorëve dhe mundësitë e punësimit. Ky informacion u jepet studentëve në etapa të ndryshme të ecurisë së tyre përmes formave të ndryshme të komunikimit: Sistemi Klasster, java e orientimit, takime me biznese, njoftimet e punësimit etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>KPT në zbatim të Statutit të KPT ka ngritur strukturën e nevojshme, me detyra të përcaktuara qartë me qëllim sigurimin e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Për këtë angazhohen zyrat e Sekretarisë Mësimore, Protokoll-Arshiva, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Zyra e Financës, Zyra IT dhe projekteve. Zyra IT kujdeset që të krijojë, ruajë dhe administrojë kopjen elektronike të dokumentacionit “letër” që krijojnë gjithë zyrat e tjera.</p> <p>KPT bazuar në Udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, dokumenton të dhënat për studentët, të dhënat për rezultatet e arritjeve akademike të studentëve dhe rezultatet e diplomimit. Në regjistrat bazë evidentohen për çdo student të regjistruar numrat vetjakë të matrikullimit, të dhëna personale, etj. Këtu pasqyrohen edhe të dhënat për studentët e transferuar apo ç’regjistruar.</p> <p>Në regjistrin e arritjeve akademike evidentohen notat për çdo lëndë të fituar, ndërsa në regjistrat e diplomimit evidentohen të dhënat për diplomën e çdo studenti të diplomuar, për çdo program studimi. Dokumentacioni mbahet konform përcaktimeve ligjore.</p> <p>[Evidenca 45 Regjistri Bazë], [Evidenca 45/1 Regjistri i arritjeve</p>

	akademike], [Evidenca 45/2 Regjistri i diplomave]
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Classter që KPT ka ngritur dhe përdor për menaxhim të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshëm dhe nga personat e autorizuar për të gjithë informacionin në lidhje me studentët. Sistemi Classter mundëson edhe gjenerimin e raporteve të ndryshme sipas kërkesave nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Financës. [Evidence 28/1 Sistemi Classter]
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Mbështetur në Statutin e KPT, Neni 16, KPT ka ngritur NjSBC si strukturë të përhershme autonome në nivel institucioni e cila bën kontrollin periodik të përvitshëm të sekretarisë mësimore, sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, procesin mësimor dhe veprimtaritë e tjera në funksion të programit të studimit. NjSBC përbëhet nga përfaqesues prej të gjithë departamenteve, një përfaqesues i jashtëm dhe një student. NjSBC ka akses në të gjithë informacionin që ka lidhje me studentët, personelin akademik, veprimtarinë e departamenteve, sekretarisë mësimore etj. NjSBC angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes rishikimit të vazhdueshëm të syllabuseve, monitorimin e aktivitetit mësimor, kontrollin e vazhdueshëm të pedagogëve të rinj prej atyre me eksperiencë, monitoron rezultatet e sondazheve të studentëve për personelin akademik, nxjerr raporte të ndryshme vlerësimi : raportin vjetor të NjSBC, raportin për cilësinë e studentëve në hyrje dhe përfundim të studimeve etj. [Evidence 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve], [Evidencë 13.2 Raporti i NjSBC]
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në KPT, përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë, harton raporte analitike, periodike 1-vjeçare ku përveç të tjerave analizon profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, përqindje e punësimit në përshtatje me diplomën etj. Këtij informacioni i bashkëngjitet edhe një propozim me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Ky raport është pjesë e raportit vjetor që KPT dorëzon çdo vit në ministrinë përgjegjëse për arsimin në lidhje me ecurinë e të gjitha programeve të studimit që KPT zhvillon. [Evidenca 36 Raporti Vjetor 20-21]
Konkluzione	<i>Në zbatim të Statutit, në përmbushje të misionit dhe objektivave të KPT, është ngritur një strukturë akademike – administrative që mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna ruhen si dokumenta në "letër" pranë zyrave</i>

	<i>përkatëse dhe Protokoll-Arshivës si dhe në formë elektronike në Sistemin Classter. Dokumentacioni që ka lidhje me studentët (të dhëna personale, arritjet akademike dhe diplomimi) ruhen në regjistra sipas udhëzimeve të MAS, konform akteve rregullatore të brendshme dhe në përputhje me ligjet në fuqi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input checked="" type="radio"/>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>KPT ka parashikuar në Statutin e tij përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese si Senati Akademik, NjSBC etj. Sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit, Statuti KPT Neni 46, çdo vit zgjidhet Këshilli Studentor i KPT me përfaqësues studentësh nga çdo program studimi dhe çdo vit akademik. Përbërja e Këshillit Studentor dhe aktivitetet që ai zhvillon paraqiten në faqen zyrtare të internetit. Nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, u konfirmua përfshirja e tyre në vendimmarrje, në të gjitha instancat që parashikojnë aktet e brendshme rregullatore në KPT.</p> <p>[Evidencë 3 Statuti i KPT], [https://kolegjiprofesional.edu.al/lista-e-ane-tare-ve-te-keshillit-te-studentevee/], [Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit]</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>KPT inkurajon një jetë studentore sa më aktive duke i përfshirë studentët dhe/ose përfaqësuesit e tyre në :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) vendimmarrje, përmes përfaqësimit të studentëve në Senatin Akademik 2) këshillim në lidhje me përmirësimin e procesit mësimor dhe shërbimeve në KPT 3) vlerësimin periodik mbi procesin akademik, përmes sondazheve sistematike që KPT zhvillon. <p>Kjo përfshirje e studentëve është reale, prek aspekte konkrete, prej studentëve konsiderohet frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> <p>[Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit]</p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në	DTI, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Diplomë Profesionale në Elektronikë, përfshin studentët në procesin e hartimit,

<p>procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, tutoriatet, me pyetësorë periodikë, focus grupe, etj.</p> <p>[Vizita në institucion, takim me studentët e programit të studimit], [Evidenca 17 Tutoriatet], [Evidenca 16 Fokus Grupet], [Evidenca 15 Formularët e vlerësimit të studentëve]</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve në KPT, në programin e studimit Diplomë profesionale në Elektronikë iu jepet mundësia të shprehin mendimin mbi patimin e barazisë dhe ndershmërisë në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, Studentët, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit kanë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Takimi me studentët në institucion e konfirmoi këtë.</p> <p>[Evidencë 4 Rregullorja e programit të studimit], [Takimi me studentët në institucion]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KPT dhe DTI bazuar në aktet e brendshme rregullatore si Statuti dhe Rregullorja e PS, përfshin dhe angazhon studentët në:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1) organet vendimmarrëse e këshilluese, si Senati Akademik, NjSBC, Këshilli Studentor 2) në veprimtaritë që DTI kryen në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, 3) Në diskutimet në Departament për përmirësimin e metodave të mësimdhënies 4) Në focus grupe, tutoriate sondazhe periodike për diskutimin e mundësive të rritjes së cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. 			
<p>Shkalla e përzmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>KPT në aktet e brendshme rregullatore ka sanksionuar procedura dhe ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Zyra e Karrierës, mbështetjes dhe informimit, dhe Zyra e Burimeve Njerëzore e Kontratave angazhohet për orientimin e</p>

	<p>studentëve në javën e parë të hyrjes në KPT, I pajis me manualin e Studentit, Kartën e Studentit, email zyrtar në KPT etj. Gjatë viteve të zhvillimit të programit të studimit, DTI angazhohet përmes personelit akademik në informimin e vazhdueshëm të studentëve, sipas fazes që ata kanë arritur në këtë zhvillim. Nga ana e studentëve u konfirmua prezenca informuese e strukturave në KPT në ndihmë të programit të studimit.</p> <p>[Vizita në institucion, takimi me studentët e PS]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>KPT ka ngritur dhe ka bërë funksional në nivel institucioni një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, siç janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit, dhe Zyra e Burimeve Njerëzore e Kontratave. Përveç këtyre njësive, KPT ka ndërtuar shërbimin e Tutoriatit dhe Koordinatorët e PS, që jep një ndihmesë më të profilizuar për studentët e programit të studimit.</p> <p>[Evidencë 17/1 Rregullore e Tutoriatit]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>KPT iu ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës përmes Zyrës së Karrierës, Mbështetjes e Informimit. Kjo Zyrë ka si qëllim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) këshillimin e karrierës 2) mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, në ambiente të dedikuara dhe orar pritjeje e person kontakti 3) jep informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, 4) ndihmon studentët në zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. <p>[Vizita në institucion], [Evidencë 21 Trajnime me studentë], [Evidencë 33 Takime me biznese]</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Një nga detyrat e Zyrës së karrierës, mbështetjes dhe informimit është të ndjekë studentët pas diplomimit, të mbledhë, të përpunojë dhe të mbajë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Kjo zyrë synon të krijojë lidhje bashkëpunimi të qëndrueshme me bizneset e fushës në tregun e punës me qëllim lehtësimin e punësimit të tyre. Njoftimet e punësimit janë të vazhdueshme dhe iu bëhen të ditura studentëve në forma të ndryshme.</p> <p>[Evidencë 12 Sondazh Alumni], [Evidencë 12.2 Punësimi i studentëve], [Evidencë 44 Njoftime punësimi]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KPT ka ngritur strukturë të dedikuar dhe ka hartuar procedura specifike për pritjen e studentëve, orientimin e tyre gjatë javës së parë në KPT, këshillimin e vazhdueshëm të studentëve përmes tutoriateve</i></p>

	<i>dhe koordinatorëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave gjatë procesit mësimor, etj. Kjo strukturë ushtron veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe është lehtësisht e arritshme nga studentët, me zyrë të dedikuar, personel përgjegjës dhe orare të afishuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Elektronikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Staf i angazhuar në këtë program studimi, me eksperiencë profesionale dhe akademike dhe i qëndrueshëm në vite.
2. Bazë laboratorike shumë e pasur dhe e azhurnuar me zhvillimet e fundit teknologjike në fushën e elektronikës dhe atë të teknologjisë së informacionit.
3. Përdorimi me efikasitet i platformave të teknologjisë së informacionit në kuadër të aktivitetit didaktik në auditor dhe online.

Pika të dobta

1. Cilësia e studentëve në hyrje është e ulët dhe numri i studentëve të regjistruar në vitet aktive ka qenë relativisht i ulët. Rritja e cilësisë së studentëve në hyrje është e rëndësishme për ecurinë e suksesshme të tyre për shkak të nivelit të vështirësisë që ky program studimi ka.

2. Prej 2 vitesh akademike nuk ka studentë të regjistruar, duke rrezikuar që të detyrojë institucionin në mbylljen e programit të studimit dhe rritje të mungesës së këtij specialiteti të shumëkërkuar në tregun e punës. Kjo shkëputje do të sjellë edhe zvogëlimin e rasteve të suksesit që është forma më e mirë e promovimit të programit të studimit. (Standardi IV.5 /Kriteri 5)

Rekomandime

1. Institucioni të angazhohet në plotësimin e rregulloreve me datën e miratimit apo hyrjes në fuqi të tyre, si dhe azhurnimit të tyre sipas ndryshimeve të brendshme institucionale apo akteve rregullatore për arsimin e lartë.
2. Institucioni të bëjë publike (në formë anonime) raportet periodike të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.
3. Institucioni të bëjë përpjekje në gjetjen e formave të tjera të promovimit të programit të studimit me karakter profesional në Elektronikë, me qëllim tejkalimin jo vetëm të ngërçit institucional që prej 2 vitesh nuk ka studentë të regjistruar, por edhe të ngërçit
4. ligjor në lidhje me pozicionimin më të mirë të diplomës së lartë profesionale kundrejt diplomave të tjera (bachelor, master etj)

Evaluation's conclusions for the professional study program "Electronics" provided by the Higher Education Institution "Professional College of Tirana"

Strengths and affirmations

1. Staff engaged in this study program, with professional and academic experience and stable over the years.
2. Very rich and updated laboratory base with the latest technological developments in the field of electronics and information technology.
3. Efficient use of information technology platforms within the didactic activity in classrooms and online.

Weaknesses

1. The quality of incoming students is low and the number of students enrolled in active years has been relatively low. Increasing the quality of incoming students is important to their successful progress due to the level of difficulty of this study program.
2. There have been no registered students for 2 academic years, risking forcing the institution to close the study program and increasing the lack of this much-requested specialty in the labor market. This disconnection will also lead to a decrease in the success rate which is the best form of promotion of the study program. (Standard IV.5 /Criterion 5)

Recommendation

1. The institution must commit to completing the regulations with the date of their approval or entry into force, as well as updating them according to internal institutional changes or regulatory acts for higher education.
2. The institution must make public (anonymous) periodic internal and external quality assessment reports.
3. The institution should make efforts to find other forms of promotion of the study program with a professional character in Electronics, with the aim of overcoming not only the institutional impasse that for 2 years there are no registered students, but also the legal impasse regarding the best positioning of the higher professional diploma against other degrees (bachelor, master, etj)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

